



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Raport Vjetor 2018

Të arriturat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2018

Përmbajta

Përmbajta	2
Lista e Grafikonëve.....	5
Lista e Tabelave	5
Shkurtesat.....	7
1. Përmbledhje Ekzekutive	9
Objektivat.....	11
2. Korniza ligjore	12
2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në	12
2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese.....	14
2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet.....	14
3. Përshkrimi i ARH-së.....	15
3.1. Misioni/Vizioni	15
3.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit.....	15
3.2.1. Departamenti i Licencimit.....	16
3.2.2. Departamenti i Sigurisë	16
3.2.3. Departamenti i Interoperabilitetit	16
3.2.4. Departamenti i Rregullimit të Tregut	17
4. Fushëveprimi institucional.....	18
4.1. Struktura organizative e ARH-së	18
4.2. Pagat e personelit të ARH-së.....	18
4.3. Skema organizative e ARH-së	19
4.4. Bordi mbikëqyrës i ARH-së	20
4.4.1. Mandati.....	20
4.4.2. Kompetencat.....	20
4.4.3. Funkcionalizimi	20

4.4.4. Puna e Bordit	21
4.4.5. Numri i mbledhjeve.....	21
4.4.6. Vendimet	21
4.4.7. Arsyetimet për vendimet	21
4.5. Ekzekutivi.....	22
4.5.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.....	22
4.5.2. Menaxhmenti i mesëm	22
4.5.3. Mandati.....	22
4.6. Burimet njerëzore	22
4.6.1. Numri i punëtorëve.....	22
4.6.2. Nevojat për punëtorë të rinj.....	22
4.6.3. Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim	23
4.6.4. Trajnimet dhe lloji i trajnimeve.....	23
4.6.5. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e ARH-së në rrafshin vendor dhe ndërkombëtar	25
4.7. Asetet.....	33
4.7.1. Asetet në posedim të institucionit	33
4.7.2. Planet për asete të reja	33
5. Përshkrimi i fushës që e mbulon ARH	34
5.1. Përshkrim i shkurtër i fushës që mbulon ARH dhe një krahasim me tri vitet e fundit 34	
5.2. Planifikimi dhe realizimi i punës 2018.....	34
5.3. Veprimet e ARH-së për përmirësimin/monitorimin e fushës së veprimit.....	36
5.4. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues.....	37
6. Puna gjatë vitit raportues	38
6.1. Aktivitetet legjislative të ARH-së	38

6.2. Përmbushja e obligimeve nga agjenda e integritit europian.....	40
6.2.1. Kërkesat e legjislacionit të BE-së për mandatin dhe pavarësin institucionale të ARH-së	42
6.3. Përfaqësimet Ligjore për aksidente hekurudhore	43
6.4. Inspektimet	44
6.4.1. Inspektimi i makinistëve	44
6.4.2. Inspektimi i Infrastrukturës Hekurudhore	44
6.4.3. Inspektimi i Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore	45
6.4.4. Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse.....	45
6.5. Monitorimet.....	47
6.5.1. Monitorimi i licencave	47
6.5.2. Monitorimi i tregut hekurudhor.....	48
6.6. Ekspozeu i Rrjetit 2019	48
6.7. Aplikime të reja	49
6.7.1. Licenca	49
6.7.2. Autorizimi i sigurisë	50
6.7.3. Certifikata e sigurisë.....	50
6.7.4. Shqyrtimi i aplikacioneve për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse.....	51
6.7.5. Njohja e Licencave për Makinist.....	51
6.8. Azhurnimi i Regjistrave	51
6.8.1. Regjistri i Licencave në kuadër të ARH-së	51
6.8.2. Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave.....	52
6.9. Regjistri Nacional I Mjeteve Lëvizëse (NVR)	52
6.10. Aktivitetet për rritjen e nivelit të sigurisë hekurudhore	53
6.10.1. Raporti Vjetor i Sigurisë.....	54

6.10.2. Azhurnimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vendore rreth HK-së.....	55
6.11. Plani Strategjik 2019 – 2023	58
6.12. Administrata	60
6.13. Financat	61
6.13.1. Pasqyrat financiare	61
6.14. Prokurimi.....	73
6.15. Marrëdhëniet me Publikun dhe Qasja në Dokumente Publike.....	74
Tabela 21. Profili i aplikuesve dhe dokumentet e kërkuara.....	77
7. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm	79
8. Shtojcat	80
8.1. Shtojca I- Përshkrimi i Hekurudhave të Kosovës	80

Lista e Grafikonëve

Grafiku 1. Realizimi i aktiviteteve gjatë vitit 2018.....	73
---	----

Lista e Tabelave

Tabela 1. Trajnimet dhe përfaqësimet kryesore gjatë vitit 2018	23
Tabela 2. Planifikimi i punës 2018 dhe realizimi	35
Tabela 3. Kompanitë hekurudhore dhe Kodi i VKM-së	46
Tabela 4. Marrëveshjet ndërkombëtare dhe vendore Hekurudhore të Kosovës.....	55
Tabela 5. Pasqyrat financiare për vitin 2018	61
Tabela 6. Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH per vitin 2018	62
Tabela 7. Realizimi i buxhetit për paga	63

Tabela 8. Pasqyra e shpenzimeve në kategorin mallra dhe shërbime	64
Tabela 9. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë Shpenzime Komunale	65
Tabela 10. Pasqyra e të hyrave vetanake	66
Tabela 11. Pasqyra e të hyrave në kategorinë subvencione dhe transfere	67
Tabela 12. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale	68
Tabela 13. Detajet e shpenzimeve nga kategoritë e Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve, Shpenzimeve Komunale dhe Shpenzimeve Kapitale për vitin 2017 (Janar - Dhjetor 2018)	72
Tabela 14. Numri i kërkesave të pranuar	74
Tabela 15. Qasja e lejuar	75
Tabela 16. Qasja e refuzuar	75
Tabela 17. Kërkesat për ri-shqyrtim	75
Tabela 18. Refuzimet dhe qasjet e kufizuara	76
Tabela 19. Kërkesat e paraqitura	76
Tabela 20. Mënyra e dërgimit të përgjigjeve	77
Tabela 21. Profili i aplikuesve dhe dokumentet e kërkuara	77
Tabela 22. Lista e dokumenteve të kërkuara	78
Tabela 23. Paraqitja tabelare e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike, në tri vitet e fundit	78

Shkurtesat

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MF	Ministria e Financave
HK	Hekurudhat e Kosovës
INFRAKOS	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
TRAINKOS	Operimi me Trena të Hekurudhave të Kosovës
RAILTRANS	Operator per transport te mallrave
ERR	Ekspozeu i Rrjetit
IRG-Rail	Indenpedent Regulatorys Group-Rail
BE	Bashkimi Evropian
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
KRPP	Komisioni rregullativ i prokurimit publik
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
OB	Organizatrat Buxhetore
ERA	European Union Agency for Railway (Agjensioni i Bashkimit Evropian i Hekurudhave)
SEETO	South-East Europe Transport Observatory (Observatori i Transportit të Evropës Juglindore)
OTIF	Organisation intergouvernementale pour les Transports Internationaux Ferroviaires (Organizimi Qeveritar për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore)
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
SMS	Safety Management System (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)
NVR	National Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)

UIC	International Union of Railway (Unioni Nderkombëtar i Hekurudhave)
ECM	Entity in Charge of Maintenance (Entiteti Përgjegjës për Mirembajtje)
CSM	Common Safety Method (Metodat e Përbashkëta të Sigurisë)
EC	European Commission (Komisioni Evropian)
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange instrument (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)
TCDD	Turkiye Cumhuriyeti Devlet Demiryollari (Hekurudhat Shtetërore të Turqisë)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet (Technical Specification for Interoperability)
NVR	Nacional Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
VKM	Vehicle Keeper Marking (Shenjëzimi i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës)
CSI	Common Safety Indicator (Indikatorët e Përbashkëta të Sigurisë)
NSA	National Safety Authority
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
AQP	Agjensioni Qendror i Prokurimit
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
NH	Ndërmarrje hekurudhore
MLJK	Mjetet lëvizëse jashtë Kosovës

1. Përmbledhje Ekzekutive

Raporti Vjetor për periudhën raportuese 01 janar-31 dhjetor 2018 i përgatitur nga Autoritetit Rregullativ i Hekurudhave (ARH), pasqyron të arriturat e ARH-së, me qëllim që të ofroj një pasqyrë të zhvillimeve në këtë fushë. Ky raport përshkruan gjerësisht aktivitetet dhe përgjegjësitë kryesore të funksionimit, siç janë: Licencimi, Siguria, Interoperabiliteti dhe Rregullimi i Tregut. Gjithashtu ky raport, përfshin sfidat të cilat e kanë përcjellë ARH-në gjatë vitit raportues.

ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i ngarkuar me përgjegjësitë për rregullimin, mbikëqyrjen si dhe organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë. ARH ofron shërbime cilësore të sigurta, transparente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Kosovë bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së.

Raporti në tërësi ofron informacion mbi: bazën ligjore, përshkrimin dhe organizimin institucional, përshkrimin e fushës që mbulon ARH, punën gjatë vitit paraprak, sfidat, raportin financiar, raportin rreth rekomandimeve të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm si dhe anekset.

Duke qenë se ARH vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut, edhe përmbajtja e raportit elaboron me specifikisht progresin dhe arritjen e objektivave të saj kryesisht në këto fusha. Edhe gjatë vitit 2018 ARH ka vazhduar të ushtrojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

Licencimi: Si organ përgjegjës për lëshimin e licencave për menaxherin e infrastrukturës, ndërmarrje hekurudhore dhe makinist, si dhe amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e këtyre, ka realizuar një sërë aktivitetesh me përkushtim dhe angazhim maksimal si: shqyrtimi i aplikacioneve të reja për licenca të makinistëve, monitorimi i licencave të lëshuara, përfshirë inspektimet për makinistët e licencuar, hartimi i raporteve të veçanta për aktivitetet e lartcekura, përditësimi i regjistrit të licencave dhe aktivitete të tjera në përputhje me legjislacionin që e rregullon këtë fushë.

Siguria: Organi i sigurisë punën dhe aktivitetin e vet gjatë vitit paraparak kryesisht e ka bazuar në Planin Vjetor të Punës. Fokusi kryesor i punës ka qenë i bazuar në disa shtylla kryesore siç janë: Kërkesat që dalin nga Ligji i Hekurudhave, përmbushja e obligimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Associmit (PKZMSA), Zbatimit të Reformave Evropiane (ERA) si dhe Obligimeve të cilat rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Transportit. Në gjatë vitit 2018 kemi përgatitur dhe janë miratuar nga Bordi i ARH-së pesë rregullore nga fusha e sigurisë. Përgatitja e Raportit Vjetor të Sigurisë për vitin 2017, Shqyrtimi i aplikacioneve të Infrakos-it (Autorizim i Sigurisë) si dhe aplikacionit të Trainkos-it (Certifikatë të Sigurisë), kemi lëshuar një Autorizim të rinovuar të Sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës pjesën A dhe B, si dhe një Certifikatë të rinovuar të sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore pjesa A dhe B. Inspektimi i të gjitha linjave dhe mjeteve lëvizëse në menaxhim të Infrakos-it si dhe janë inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse në menaxhim të Trainkos-it, Railtrans-it dhe Ferronikel-it. Pas procesit të inspektimit në kemi përgatitur nga një raport me rekomandime për të gjitha të gjeturat gjatë inspektimeve.

Të gjitha këto raporte të përgatitura nga ana jonë janë dërguar te kompanitë përkatëse, kurse në këtë raport janë futur si shtojca.

Interoperabiliteti: Nga obligimet që derivojnë nga ligji i hekurudhave dhe agjenda e integritit evropian, organi për interoperabilitet ka realizuar aktivitetet si në vazhdim: përgatitjen e rregulloreve për Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin Infrastrukturë STI INF dhe Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet STI për nënsistemin Operimi dhe Menaxhimi i Trafikut STI OPE, inspektimet e mjeteve lëvizëse NVR të të gjitha kompanive hekurudhore dhe përgatitjen e raporteve me rekomandime ndaras për secilën kompani, azhurnimin e regjistrit NVR, listimin e marrëveshjeve nderkufitare hekurudhore, etj.

Rregullimi i Tregut: Rregullimi i Tregut: Organ përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, ka zhvilluar aktivitete të cilat vlerësohen në këtë fushë:

Mbikëqyrja e procesit të konsultimit për Ekspozeun e Rrjetit 2018 duke siguruar që Ekspozeu i Rrjetit të mos përmbajë klauzola diskriminuese jo transparente, shqyrtimi i ankesave të pranuar, sigurimi që qasja në binarë, stacione, depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejtë transparente dhe jo diskriminuese. Puna dhe angazhimi i rregullimit të tregut ka qenë e fokusuar në gatishmërinë e vazhdueshme që të merren masa kur

është e nevojshme për të arritur këtë. Gjithashtu është bërë edhe monitorimi i tregut hekurudhore si dhe është përgatitur Raporti Vjetor i Monitorimit të Tregut 2017 dhe është dërguar në IRG-Rail. Rregullimi i Tregut ka bashkëpunuar me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor, veçmas sa i përket Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-së dhe IRG – Rail në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor me vendet e tjera.

Objektivat

ARH do të vazhdojë të jetë një rregullator aktiv dhe shumë i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të transportit hekurudhor në vend, duke siguruar vazhdimësinë e angazhimeve të ARH-së edhe për vitet e ardhshme. Jemi të bindur se në sajë të përpjekjeve tona të përbashkëta, për vitin e ardhshëm do të kemi rezultate shumë më të mira në sektorin e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

ARH edhe më tej vazhdon të këtë qëllim kryesor zhvillimin e një sistemi efikas dhe të sigurt të transportit hekurudhor, të integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-së, që promovon zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

2. Korniza ligjore

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në

- Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063;
- Rregullore e Brendshme e ARH për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012, për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012, për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012, për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore;
- Rregulloren Nr. 01/2012, për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- Rregullore Nr. 03/2012, për Certifikatat e Sigurisë;
- Rregullore Nr. 05/ 2012, për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore;
- Rregullore Nr. 06/ 2012, për Regjistrimin e Infrastrukturës;
- Rregulloren Nr. 01/2013, për Ekspozeun e Rrjetit;
- Rregulloren Nr. 02/2013, për Licencimin e Makinistëve;
- Rregullore Nr. 01/2014, për Modelin e Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor;
- Rregullore Nr. 01/2017, për Taksa dhe Gjobat;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Raportimin e Monitorimit të Tregut Hekurudhor;
- Rregullore Nr. 03/2017 për Të Drejtat e Udhëtarëve;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Metodat e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore;

- Rregullore Nr. 05/2017, Metodatat e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut;
- Rregullore Nr. 06/2017 për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të ARH-së;
- Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Operatorëve Hekurudhor me Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2017;
- Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherit të Infrastrukturës me Udhëzimin Administrativ Nr. 18/2017;
- Rregullorja nr. 01/2018 për llogaritjen e kostos direkte; Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2015/909 / BE;
- Rregullorja nr. 02/2018 për metodatat e përbashkëta të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e certifikatave të sigurisë hekurudhore. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 1169/2010 / BE;
- Rregullorja nr. 03/2018 për ndërtimin, përmirësimin, ripërtëritjen, vlerësimin e konformitetit dhe autorizimin për funksionalizimin e mjeteve lëvizëse. Kjo Rregullore transponon pjesërisht direktivat dhe rregulloret e BE si: 2004/49 / EC, 2008/57 / EC, 2009/131 / EC, 2008/110 / EC si dhe Rregullorja nr. 402/2013 / BE;
- Rregullorja Nr 04/2018 për Caqet e Përbashkëta të Sigurisë (CST). Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2010/409 / BE;
- Rregullorja Nr. 05/2018 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin 'Infrastrukturë'. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së nr. 1299/2014;
- Rregullorja nr. 06/2018 për përdorimin e një formati të përbashkët evropian për certifikatat e sigurisë, dokumentet e aplikimit dhe vlefshmërinë e certifikatave të sigurisë. Kjo rregullore transponon rregulloren e BE-së nr. 653/2007 / EC;
- Rregullorja Nr.07 / 2018 për miratimin e një metode të përbashkët të sigurisë për vlerësimin e arritjes së objektivave të sigurisë. Kjo rregullore transponon Vendimin e BE-së Nr. 2009/460 / BE; dhe
- Rregullorja Nr. 08 / 2018 mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin 'Operimit dhe Menaxhimit të Trafikut' STI OPE. Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2015/995.

2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Nga ana e ARH-së, ka pasur iniciativë për fillimin e procedurave për plotësim/ndryshim përmbajtësor të Ligjit ekzistues të hekurudhave.

Pavarësisht nga fakti që Ligji për Hekurudhat e Kosovës, gjatë vitit 2018 është amendamentuar në pjesën e cila ka të bëjë me lartësinë e gjobave, me qëllim të harmonizimit të kësaj pjese me Ligjin për Kundërvajtje, ky plotësim/ndryshim, nuk e ka përmirësuar substancialisht bazën ligjore të sektorit hekurudhor dhe as pikat që ka adresuar ARH.

2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet

ARH identifikon dhe raporton vështirësitë për të cilat vlerëson se ndikojnë në zbatimin efektiv të Ligjit të Hekurudhave. Gjatë zbatimit, kemi hasur në disa paqartësi rreth kompetencave ndërinstytucionale, me theks të posaçëm mes Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Ministrisë së Infrastrukturës si dhe mos përputhshmërisë me disa nga Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e transportit hekurudhor.

ARH raporton se deri në këtë periudhë nuk ka pasur ndonjë ndryshim të legjislacionit i cili do të ndikonte në qartësimin e kompetencave ndër institucionale, pavarësisht faktit se ARH ka kërkuar një gjë të tillë.

3. Përshkrimi i ARH-së

ARH është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-076 dhe ka filluar të funksionoj nga prilli i vitit 2010, ndërsa tani ARH funksionon sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës. ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj, si dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

3.1. Misioni/Vizioni

Misioni

Misioni i ARH-së është rregullimi, mbikëqyrja dhe organizimi i sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës në këto fusha: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji.

Vizioni

Vizioni i ARH-së është që të ofroj shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

3.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit

Sipas Ligjit për Hekurudha, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave rregullon dhe mbikëqyrë katër fusha specifike përmes këtyre departamenteve profesionale:

3.2.1. Departamenti i Licencimit

Departamenti i pavarur përgjegjës për lëshimin e licencave për menaxherët e infrastrukturës, ndërmarrjet hekurudhore dhe makinistët. Si dhe, monitorimin e licencave të lëshuara.

3.2.2. Departamenti i Sigurisë

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar nën mbikëqyrjen e ARH-së për të siguruar që siguria hekurudhore është mbajtur dhe përmirësuar pas rindërtimit të sistemit hekurudhor në Kosovë. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore është i pavarur në organizimin e vet strukturën ligjore dhe vendim marrjen nga ndonjë ndërmarrje hekurudhore, menaxher i infrastrukturës, aplikues apo entitet i prokurimit.

Gjithashtu ky departament është përgjegjës për lëshimin, rinovimin, amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e autorizimit dhe certifikatave të sigurisë, autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor, mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar, mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore, mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës.

3.2.3. Departamenti i Interoperabilitetit

Departamenti i Interoperabilitetit brenda ARH-së, është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova. Kushtet në lidhje me interoperabilitetin përmbajnë dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit e gjithashtu edhe kualifikimeve profesionale dhe kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit i cili kontribuon në operimet dhe mirëmbajtjen e tij,

3.2.4. Departamenti i Rregullimit të Tregut

Departament i pavarur përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, monitorimi i tërë tregut hekurudhor në Kosovës, dhe shqyrtimin ankesave për tregun hekurudhor, sigurimin se që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese, mbikëqyrjen e negocimeve ndërmjet aplikueseve dhe menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelin e pagesës për infrastrukturë, dhënien e kontributit për të zhvilluar sistem të integruar të transportit të udhëtareve dhe mallrave.

4. Fushëveprimi institucional

4.1. Struktura organizative e ARH-së

Struktura e ARH-së, miratohet nga Bordi dhe përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Struktura organizative e ARH-së në bazë të Ligjit të Hekurudhave dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës, përbëhet nga:


- a) Bordi Mbikëqyrës;
- b) Drejtori i Përgjithshëm;
- c) Departamenti Ligjor/Licencim;
- d) Departamenti i Sigurisë;
- e) Departamenti i Interoperabilitetit;
- f) Departamenti i Rregullimit Tregut;
- g) Departamenti i Administratës;
- h) Departamenti i Financave;
- i) Divizioni i Prokurimit

Në bazë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës skematikisht është paraqitur struktura organizative e ARH-së

4.2. Pagat e personelit të ARH-së

ARH ka prioritet mbikëqyrjen dhe sigurinë e sektorit hekurudhor. ARH-ja siguron që operimet hekurudhore në Republikën e Kosovës të realizohen në përputhje me Ligjin e Hekurudhave dhe standardet e BE-së. Për ta arritur këtë, rregullatori i hekurudhave të Kosovës ka nevojë për personel shumë të kualifikuar dhe me përvojë për t'i hartuar standardet, procedurat, rregulloret dhe për të siguruar zbatimin e tyre nga operatorët përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe inspektimeve. Përkundër kësaj niveli i pagave të personelit të ARH-së që nga themelimi vazhdon që të jetë mjaft i ulët në krahasim me pagat e personelit të industrisë së hekurudhave dhe rregullatorëve tjerë të pavarur. Personeli i ARH nuk gëzon asnjë kompensim shtesë përveç pagës bazë nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës. Si rezultat ARH rrezikon humbjen e stafit profesional aq më tepër në këtë kohë kur investimet janë drejtuar seriozisht në këtë sektor.

4.3. Skema organizative e ARH-së



4.4. Bordi mbikëqyrës i ARH-së

Veprimtaria e ARH-së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës, i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi ARH-së përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe njëri prej tyre zgjidhet Kryesues, anëtari i pestë i Bordit është Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Takimet e Bordit drejtohen në pajtim me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi dhe së paku një (1) herë në muaj. Mbledhjet e Bordit nuk mund të zhvillohen nëse nuk ka kuorum. Vendimet e Bordit merren me shumicën e votave. Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.

4.4.1. Mandati

Kuvendi i emëron katër (4) anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet kryesuesi i Bordit të cilët propozohen nga Qeveria me rekomandim të Ministrisë. Çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat pesë vjeçar (5), i cili mund të emërohet më së shumti edhe për një (1) mandat.

4.4.2. Kompetencat

Bordi mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e aktiviteteve dhe vendimeve të ARH-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore, sic janë: licencimi, siguria, interoperabiliteti si dhe rregullimi tregut dhe aspekteve të menaxhimit financiar, të hyrave dhe shpenzimeve të ARH-së. Bordi i ARH-së, miraton të gjitha aktet nënligjore të departamenteve të cilat janë në kuadër të sajë.

4.4.3. Funksionalizimi

Bordi Mbikëqyrës i ARH-së është funksional në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij.

4.4.4. Puna e Bordit

Bordi Mbikëqyrës i ARH-së, punën dhe përgjegjësinë e vet e kryen bazuar në kompetencat ligjore që ka. Puna e Bordit është e fokusuar në mbikëqyrjen e realizimit të punëve dhe detyrave të institucionit si dhe në vendimmarrjen në proceset që janë në kompetencë të Bordit.

Duhet theksuar se puna në mbikëqyrje, vendimmarrje dhe përfaqësim, është bërë në koordinim të plotë mes anëtarëve të Bordit por edhe në konsultim të vazhdueshëm me Drejtorin e Përgjithshëm, rrjedhimisht me menaxhmentin.

4.4.5. Numri i mbledhjeve

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave, Bordi Mbikëqyrës, duhet të mbajë të paktën një mbledhje në çdo muaj, dhe sipas nevojës mund të zhvilloj edhe mbledhje tjera, varësisht nga nevojat dhe kërkesat.

Brenda vitit 2018, ARH ka mbajtur 15 takime të rregullta.

4.4.6. Vendimet

Vendimet e Bordit të ARH-së, të cilat vlen të theksohen janë:

- Vendimet për miratimin e rregulloreve, të cilat janë cekur më lartë
- Vendimet për miratim të Raportit Vjetor 2017
- Vendimet për miratim të raporteve të sigurisë, tregut, etj.
- Vendimi për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, etj.

4.4.7. Arsyetimet për vendimet

Të gjitha vendimet e Bordit, janë marrë brenda kornizës ligjore dhe mandatit që Bordi i ARH-së ka në bazë të Ligjit të Hekurudhave si dhe rregullores për funksionimin e brendshëm të ARH-së.

4.5. Ekzekutivi

4.5.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për menaxhimin dhe drejtimin e punëve të përditshme dhe në pajtim me politikat dhe udhëzimet e nxjerra nga Bordi. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet nga Bordi Mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi për Shërbimin Civil. Ai që nuk ka të drejtë të shërbejë në Bord nuk do të ketë të drejtë të emërohet as Drejtor i Përgjithshëm.

4.5.2. Menaxhmenti i mesëm

Menaxhmenti i mesëm i ARH-së përbëhet nga Drejtorët e Departamenteve dhe stafi profesional, të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre të përshkruara me detyrat e punës. Drejtori i Përgjithshëm i ngarkon strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara sipas Rregullores së Brendshme dhe mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e ARH-së një strukture apo punonjësi jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture, nëse ai e sheh të nevojshme.

4.5.3. Mandati

Drejtori i Përgjithshëm, është me kontratë punësimi me kohë të caktuar.

Zyrtaret që përbëjnë strukturën të ARH-së mbajnë Akte Emërimi me kohë të pacaktuar, ndërsa lloji i emërimit është i karrierës.

4.6. Burimet njerëzore

4.6.1. Numri i punëtorëve

ARH-ja ka 19 punëtorë shërbyes civil, pa përfshirë katër (4) anëtarët e Bordit të cilët nuk janë shërbyes civil.

4.6.2. Nevojat për punëtorë të rinj

ARH ka nevojë për punëtorë të rinj shtesë, në mënyrë që të përmbush mandatin e vet ligjor.

4.6.3. Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim

Zyrtarët e ARH –së gjatë vitit 2018 kanë marrë pjesë në trajnime të financuara nga donatorë ndërkombëtar, në vende të ndryshme të BE-së si dhe vende të regjionit. Po ashtu, zyrtarët e ARH-së gjatë vitit raportues kanë ndjekur trajnime brenda vendit, të organizuara nga institucionet kompetente siç janë: Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Financave (MF), Ministria e Integritetit dhe Korrupsionit (MIE), etj.

ARH, krahas zhvillimeve të reja, në vazhdimësi ka nevojë për ngritje të kapaciteteve profesionale duke ndjekur trajnimet e nevojshme në fushën e licencimit, sigurisë, interoperabilitetit, rregullimit të tregut si dhe në fushat tjera mbështetëse, si: administratë, financa dhe prokurim.

Trajnimet, vizitat studimore dhe punëtoritë kryesore janë paraqitur në formë tabelare si në vijim:

4.6.4. Trajnimet dhe lloji i trajnimeve

Tabela 1. Trajnimet dhe përfaqësimet kryesore gjatë vitit 2018

Nr.	Trajnimi	Organizatori/Implementuesi
1	Takimi 48-të Plenarë i Rrjetit të Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë dhe takimin e 37-të Plenarë të Organeve për Hetimin e Aksidenteve hekurudhore, Valenciennes Francë	Agjencia Evropiane e Hekurudhave – ERA
2	Punëtorija me vendet e IPA-s “Sfidat e reja për autoritetet hekurudhore në Ballkanin Përendimor”, Budapest Hungari	Agjencia Evropiane e Hekurudhave – ERA, Ministria e Transportit e Hungarisë, Agjensioni i Sigurisë Hekurudhore Hungareze dhe Universiteti Teknik i Hungarisë
3	Takim me antarët e IRG-Rail, Romë Itali	IRG-Rail
4	Trajnim me Agjencionin Evropian të Hekurudhave	ERA
5	Pjesëmarrje në konferencën që organizohet nga Munich Satellite Navigation Summit 2018	Munich Satellite Navigation Summit 2018

6	Raportim në Komisionin Evropian	KE
7	Trajnim me Agjencionin Evropian të Hekurudhave	ERA
8	Takim me antarët e IRG-Rail	IRG-Rail
9	Trajnim me Agjencionin Evropian të Hekurudhave	ERA
10	Seminarin e organizuar nga Instituti për Kontabilitet, Auditim, Financa (KAF) lidhur me “Menaxhimi i rrezikut dhe roli i auditorit të brendshëm”	IKAF
11	Pjesmarrje në InnoTrans 2018	Innotrans
12	Takim me antarët e IRG-Rail	Irg-Rail Grup
13	Trajnim me Agjencionin Evropian të Hekurudhave	ERA
14	Pjesëmarrje në takimin e Strategjisë Transnacionale (initCOSEERail) dhe takimin nga CER (Agjencioni Evropian për Hekurudha	□
15	Përafrimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian	IKAP
16	Dizajnimi dhe menaxhimi i politikave publike të integritimit evropian	IKAP
17	Fondet IPA II dhe Menaxhimi i ciklit të projekteve	IKAP
18	Asistenca e jashtme monitorimi dhe vlerësimi i projekteve“.	IKAP
19	Qasja strategjike e programimit të IPA	IKAP
20	Hulumtimet dhe analiza shkencore me SPSS	IKAP
21	CorelDRAW X7	IKAP
22	Llogaridhënia menaxherjele, Menaxhimin e rrezikut dhe hartimin e listës së rreziqeve	MF
23	Ndikimi i Ligjit të ri të Procedurës së Përgjithshme Administrative (LPPA) në procedurën e rekrutimit dhe ankimimin në Shërbimin Civil,	IKAP
24	Zbatimi i Udhëzuesit dhe Doracakut të ri për hartimin e koncept dokumenteve	Zyra Kryministrit

25	Shfrytëzimi efektiv i rrjeteve sociale ne Administratën Publike	IKAP
26	e-Qeverisja & m-Qeverisja".	IKAP
27	Komunikimi dhe hartimi i shkresave ne Administratë Publike	IKAP
28	Motivimi dhe Udhëheqja e Punonjësve".	IKAP

4.6.5. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e ARH-së në rrafshin vendor dhe ndërkombëtar

ARH ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare për transportin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe ka ofruar përkrahje profesionale në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Takimi 48^{të} Plenarë të Rrjetit të Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë

Në këtë takim të 48^{të} plenarë të organizuar nga Agjencioni Evropian i Hekurudhave (ERA) i mbajtur me datë: 29-31.05.2018, kanë marrë pjesë përfaqësues nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe nga vendet e IPA-s. Ky takim u organizua dhe sponsorizua nga ERA, në këtë takim u trajtuan shumë tema siç janë kultura e sigurisë dhe roli i agjencioneve nacionale të sigurisë, u diskutua për politikën e implementimit të Rregullave nacionale të Sigurisë ashtu siç është paraparë me Direktivën e Sigurisë Nr. 2016/798/EU, prezantimi ishte përgatitur nga ana e ERA-s. Pikë tjetër e rëndësishme e takimit ishte edhe bashkëpunimi ndërmjet Organeve për Vlerësimin e Metodave të Përbashkëta të Sigurisë, këtë pikë e shtjelloi agjencia e sigurisë e Danimarkës. Një prezantim i rëndësishëm ishte edhe ai i implementimit të pakos së 4^{të} hekurudhore ku në kuadër të kompetencave të reja të ERA-s do të jetë edhe OSS (One Stop Shop), pra kryerja e të gjitha aplikimeve nga ana e operatorëve hekurudhor në një vend pra në ERA (që ka të bëjë me dhënien e certifikatës unike të sigurisë në nivel Evropian).

Një diskutim i veçantë ishte ai ndërmjet ERA-s dhe vendeve të IPA lidhur me rezultatet e arritura, si dhe planet për të ardhmen. ERA për vitin 2018 dhe 2019 ka paraparë programe trajnimi për vendet e IPA-s, ku për vitin 2018 ka paraparë që të pranojë dy ekspertë nga vendet e IPA-s kurse për vitin tjetër edhe tre të tjerë.



Fotografia 1. Takimi 48^{të} Plenarë të Rrjetit të Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë

Punëtorja me vendet e IPA-s “Sfidat e reja për autoritetet hekurudhore në Ballkanin Perëndimor”

Me ftesë të ERA-s me datë (16-17).10.2018 dy përfaqësues të ARH-së kanë marrë pjesë në takimin e organizuar në Budapest nga ERA, Ministria e Transportit të Hungarisë dhe Agjencioni i Sigurisë hekurudhore Hungareze. Tema: Trajnim në Budapest të Hungarisë i organizuar nga ERA-Unioni Evropian Agjencioni për hekurudha, Ministria e Transportit e Hungarisë, Agjencioni i Sigurisë Hekurudhore dhe Universiteti Teknik i Hungarisë. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e IPA-s si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Turqia. Trajnimit ka mbuluar aspekte të temave të cilat mbulohej nga projekti i IPA-s, ku kanë marrë pjesë vetëm vendet e Ballkanit perëndimor, ku është diskutuar mbi “Sfidat e reja për Autoritetet hekurudhore në Ballkanin Perëndimor”. Në këtë takim u diskutua mbi metodën dhe principet e reduktimit të rregullave nacionale të sigurisë, ku u paraqitën përvojat e Hungarisë në këtë drejtim. Gjithashtu në takim u paraqitën edhe përvoja e reduktimit të rregullave nacionale nga ana e Sllovenisë dhe Kroacisë, ku përfaqësuesit e Agjencioneve të sigurisë së këtyre dy vendeve treguan për formën se si kanë filluar me reduktimin e rregullave nacionale të sigurisë

në vendet e tyre. Pas diskutimeve ndërmjet përfaqësuesve të ERA-s, Komisionit Evropian, SEETO-s dhe vendeve të IPA-s si konkludim doli se duhet të bëhen më shumë përpjekje për të filluar me krijimin e grupit punues i cili do të merrej me reduktimin e rregullave nacionale të sigurisë në vendet e IPA-s, nën monitorimin e ERA-s.



Fotografia 2. Punëtorja me vendet e IPA-së

Inotrans 2018

Përfaqësues të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës kanë marrë pjesë në InnoTrans 2018, i cili është mbajtur në Berlin të Gjermanisë, nga data 18-21 Shtator 2018. Në margjinat e këtij organizimi mes tjerash, përfaqësuesit e ARH-së kanë realizuar takim me përfaqësuesit e Universitetit Teknik të Dresdenit të Gjermanisë. Në këtë takim janë diskutuar tema me interes të përbashkët në fushën e hekurudhave, me theks të veçantë ngritja e nivelit të sigurisë hekurudhore në Republikën e Kosovës.



Fotografia 3. Pjesëmarrja në Inotrans 2018

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave me bashkëpunëtorë ka pritur në takim përfaqësuesin e Universitetit Teknik të Dresdenit, Dr. Ing. Eric Schöne

Drejtori i përgjithshëm i ARH-së, Shkelzen Qorri me bashkëpunëtorët e tij ka pritur në takim përfaqësuesin e Universitetit Teknik të Dresdenit Dr. Ing. Eric Schöne, ku mes tjerash është sjellë draft Marrëveshja e Bashkëpunimit, e cila pritet të nënshkruhet në mes të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Universitetit Teknik të Dresdenit.



Fotografia 4. Në takim përfaqësuesin e Universitetit Teknik të Dresdenit, Dr. Ing. Eric SchÖne

Po ashtu, në këtë takim z. EricSchöne ka bërë një prezantim të projekteve në fushën e hekurudhave që Universiteti Teknik i Dresdenit ka kryer (realizuar) në Gjermani si dhe ato të ngjashme të cilat mundë të kryhen dhe i përgjigjen sektorit hekurudhor në Kosovë, përmes projekteve të përbashkëta.

Çështjet kryesore të projekteve të përbashkëta të cilat janë diskutuar, kanë të bëjnë me sigurinë në komunikacionin hekurudhor brenda territorit të Kosovës, me theks të veçantë hartimin i rregullave për sinjalizimin e vendkalimeve në nivel rruge/hekurudhe dhe çështja e makinistëve të trenave. Ky takim ka qenë vazhdimësi e takimit paraprak të mbajtur në margjinat e InnoTrans 2018 në Berlin.

Referuar gatishmërisë së ndërsjellë, këto takime do të vazhdojnë edhe në të ardhmen dhe do të kurorëzohen me projektet konkrete në të mirë të sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Takimet nëpër komunat

Duke marrë për bazë numrin e aksidenteve hekurudhore të cilat kanë ndodhur në vitet paraprake, si dhe me qëllim të sensibilizimit të opinionit, ARH ka ndërmarr aktivitete të shumta që përfshinë vizitat dhe takimet më udhëheqës komunal në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, në të cilat shtrihet linja hekurudhore, linja të cilat janë në shfrytëzim.



Fotografia 5. Takimi me Udhëheqjen e Komunës së Hanit të Elezit

Përmes këtyre takimeve është synuar që fillimisht të arrihet një bashkëpunim në mes të ARH-së dhe këtyre komunave, i munguar deri me tani, si dhe sqarimi i detyrave dhe përgjegjësive të Komunave përkatëse në raport me Ligjin për Hekurudha. Kjo iniciativë është mirëpritur dhe vlerësuar lartë nga autoritetet komunale, duke ofruar gatishmërinë e plotë për bashkëpunim me ARH-në me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë hekurudhore.



Fotografia 6. Takimi me Udhëheqjen e Komunës së Klinës

Realizimi i këtij projekti ka ndikuar në krijimin e një praktike të re të bashkëpunimit ndërinstytucional, e cila ka ndikuar në nxitjen e planifikimit të aktiviteteve tjera të përbashkëta në të ardhmen, me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë që do të ndikonte në parandalimin e aksidenteve hekurudhore.



Fotografia 7. Takimi me Udhëheqjen e Komunës së Prishtinës

Në aspektin e sigurisë, gjatë këtyre takimeve, diskutime kishte posaçërisht për përgjegjësitë ligjore (Ligji për Hekurudhat) si dhe sqarimin e këtyre përgjegjësive në mes të Ministrisë, komunave, Menaxherit të Infrastrukturës dhe akterëve tjerë. Në kuadër të kësaj, me theks të veçantë është diskutuar çështja e vendkalimeve hekurudhore, legale dhe ilegale, sinjalizimi, aksidentet hekurudhore, pastrimi i brezit hekurudhor etj. Siç u theksua edhe më lartë, këto takime janë realizuar në komunat nëpër të cilat shtrihet linja hekurudhore, që përfshinë komunat: Hani i Elezit, Kaçanik, Ferizaj, Lipjan Fushë Kosovë, Prishtinë, Obiliq, Drenas, Klinë dhe Pejë.



Fotografia 8. Takimi me Udhëheqjen e Komunës së Ferizajtit



Fotografia 9. Takimi me Udhëheqjen e Komunës së Obiliqit

4.7. Asetet

4.7.1. Asetet në posedim të institucionit

ARH-ja ka në përdorim 297 asete me vlerë në blerje prej 114,250.12 €. Këto asete janë kryesisht orendi zyresh dhe pajisje teknologjike. Zhvlerësimi i aseteve behet çdo fund vit sipas dispozitave të Rregullores MF-NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare ne organizatat buxhetore dhe sipas udhëzimit nr 01/2012 për Menaxhimin e pasurisë. Zhvlerësimi i aseteve ne ARH është kryer për asetet mbi 1000 € dhe nën 1000 €. Sipas raportit të komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit, vlera e aseteve në ARH për vitin 2018 sipas rregullave të parapara me rregulloren e lartcekur është 17.505.24 euro.

4.7.2. Planet për asete të reja

Ka qenë dhe vazhdon të jetë kërkesë e ARH-së sigurimi i zyrave të sajë brenda përbrenda një institucioni publik, me qëllim të evitimit të pagesës së qirasë. Pavarësisht disa kërkesave të ARH-së drejtuar MAP-it, akoma kjo çështje nuk është zgjidhur dhe vazhdon të jetë ngarkesë buxhetore për institucionin.

Zyrat e ARH-së janë në Prishtinë në Rr. “Rrustem Statovci” nr. 29. Hapësira fizike e institucionit të ARH-së është 400 m².

Investim tjetër i nevojshëm është edhe furnizimi me pajisje të teknologjisë informative, me inventar për zyre dhe mjete tjera për nevoja të ARH-së, etj.

5. Përshkrimi i fushës që e mbulon ARH

5.1. Përshkrim i shkurtër i fushës që mbulon ARH dhe një krahasim me tri vitet e fundit

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH ofron shërbime cilësore të sigurta, transparente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së.

Krahasuar me tri vitet paraprake, duhet theksuar se ARH ka filluar të gjeneron të ardhura nga aplikimet e ndërmarrjeve hekurudhore për shërbimet të cilat ARH i ofron bazuar në Rregulloren për të Hyra dhe Taksat. Ndërsa, nga aspekti i angazhimeve në pasurimin e infrastrukturës ligjore, ARH ka miratuar disa rregullore të nevojshme, të cilat i kemi listuar te pika 2.2. e këtij raporti.

5.2. Planifikimi dhe realizimi i punës 2018

Plani i Punës shërben për koordinimin e aktiviteteve të ARH-së dhe departamenteve përkatëse të tij, në mënyrë që të mundësohet përmbushja efikase dhe me kohë e synimeve dhe objektivave të përcaktuara. Plani i punës hartohet në atë formë duke i identifikuar objektivat e nevojshme vjetore për përmbushjen e obligimeve ligjore, të cilat hartohen në nivel të menaxhmentit. Prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë në konsistencë me misionin dhe përgjegjësitë e ARH-së të përcaktuara me Ligjin e Hekurudhave të Kosovës. Realizimi i Planit Vjetor të punës rishikohet nga menaxhmenti i ARH-së.

Tabela 2. Planifikimi i punës 2018 dhe realizimi

Realizimi i Planit të Punës për vitin 2018							
Aktivitetet e planifikuara		Periodha				Statusi	Përfunduar
		K	K	K	K	Pa Përfunduar	
		I	II	III	IV		
1	Nxjerrja e të gjitha akteve nënligjore të planifikuara në bazë të agjendës të paraparë në PKZMSA, agjendës së reformave evropiane dhe ligjit të hekurudhave në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së.	x	x	x	x	E realizuar	
2	Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore në bazë të LMFP-së	x				E realizuar	
3	Shqyrtimi i aplikacionit të Infracos-it për renovimin e Autorizimit të Sigurisë	x				E realizuar	
4	Shqyrtimi i aplikacionit të Trainkosit-it për renovimin e Certifikatës së Sigurisë	x				E realizuar	
5	Shqyrtimi i aplikacioneve për licenca të makinistëve	x	x	x	x	E realizuar	
6	Regjistrimi i mjeteve lëvizëse	x	x	x	x	E pa realizuar (ARH nuk ka pranuar asnjë aplikacion për regjistrim të mjeteve lëvizëse)	
7	Inspektimi i makinistëve të licencuar dhe përgatitja e raporteve të inspektimit të makinistëve	x	x	x	x	E realizuar	
8	Rregullat Nacionale të Sigurisë	x	x	x	x	E pa përfunduar (Agjencioni Evropian i Hekurudhave ka marrë përsipër që në bashkëpunim me vendet e IPA-s të përgatis Rregullat Nacionale të Sigurisë)	
9	Mbikëqyrja e implementimit të rekomandimeve nga inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe infrastruktura hekurudhore gjatë vitit 2017	x	x	x	x	E realizuar	
10							
11	Shqyrtimin e ankesave për tregun hekurudhor në transportin e mallrave si dhe për të drejtat e udhëtareve			x	x	E realizuar	
12	Monitorimi i marrëveshjes për kompensimin e “Obligimeve të Shërbimeve Publike”	x	x	x	x	E realizuar	
13	Monitorimi dhe kontrollimi i “Marrëveshjes mbi qasjen” në mes të Menaxherit të infrastrukturës dhe operatorëve hekurudhor.	x	x	x	x	E realizuar	
14	Bashkëpunimi dhe koordinimi i të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara me rregullator vendor dhe ndërkombëtar e në veçanti me IRG-Rail të Evropës	x	x	x	x	E realizuar	

15	Përgatitja e Barazimeve vjetore si dhe Përgatitja dhe dorëzimi i Qarkores Buxhetore	X	x	x	x	E realizuar
16	Realizimi i Planifikimit të Prokurimit sipas nevojave të ARH-së	X	x	x	x	E realizuar
17	Azhurnimi i Regjistrit të Makinistëve të Licencuar	X	x	x	x	E realizuar
18	Mbikëqyrja e performancës së sigurisë për MI dhe NH	X	x	x	x	E realizuar
19	Monitorimin e tregut hekurudhor në Kosovë, dhe përgatitjen e raportit të monitorimit të tregut Hekurudhor	X	x	x	x	E realizuar
20	Sigurimin së pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës janë transparente dhe jo diskriminuese	X	x	x	x	E realizuar
21	Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë			x		E realizuar
22	Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për Qasje në Dokumente Publike, si dhe raportimi në ZKM sipas periudhave të parapara ligjore.	X	x	x	x	E realizuar
23	Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës		x	x	x	E realizuar
24	Inspektimi i mjeteve lëvizëse në menaxhim të Infrakos, Trainkos, Rail Trans dhe Feronikel		x	x	x	E realizuar
25	Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse				x	E realizuar

5.3. Veprimet e ARH-së për përmirësimin/monitorimin e fushës së veprimit

- Monitorimi i Tregut Hekurudhor;
- Avancimi në aspektet e sigurisë hekurudhore, përmes inspektimeve dhe dhënies së rekomandimeve;
- Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet nënligjore për përafrim me Direktivat Evropiane;
- Shqyrtimi i aplikacioneve të reja për Licencim të makinistëve, si dhe monitorimi i atyre ekzistuese;
- Dhënia e Autorizimit të rinovuar të sigurisë për menaxherin e infrastrukturës - Infrakos;
- Dhënia e Certifikatës së rinovuar të Sigurisë për operatorin hekurudhor - Trainkos.

5.4. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues

- Përgatitja dhe implementimi i Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet;
- Mbikëqyrja e procesit të përgatitjes profesionale të makinistëve;
- Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet nënligjore nga ana e ARH-së dhe MI-së, në harmoni me legjislacionin e BE-së;
- Plotësim/ndryshimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës dhe adaptimi me nevojat dhe kërkesat praktike;
- Përgatitja e Rregullave Nacionale të Sigurisë.

6. Puna gjatë vitit raportues

Aktivitetet dhe të arriturat kryesore të ARH-së gjatë vitit 2018 janë:

6.1. Aktivitetet legislative të ARH-së

ARH, në njërën nga përgjegjësitë e veta ligjore dhe institucionale për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sektorit hekurudhor ka hartimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore. Gjatë vitit 2018, ARH ka pasur në programin e punës së sajë hartimin dhe miratimin e disa akteve nënligjore. Vlen të ceket se shumica nga aktet nënligjore që ARH ka draftuar dhe miratuar gjatë vitit 2018, përveç se bazohen në kërkesat dhe nevojat e sektorit hekurudhor, të njëjtat derivojnë nga: Ligji për Hekurudhat, Traktati i Komunitetit të Transportit, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, e të cilat janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me procesin e integritimeve Evropiane.

Si rezultat i punës dhe angazhimit, ARH gjatë vitit 2018 ka arritur që të përfundoj të gjitha rregulloret e planifikuara, brenda afateve të parapara në PKZMSA, kështu duke ndikuar pozitivisht në indikatorët matës që BE-ja ju bënë institucioneve të Republikës së Kosovës në raport me obligimet që rrjedhin nga MSA-ja.

ARH-ja, në grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore, përveç stafit të brendshëm në secilin grup punues ka ftuar dhe përfshirë edhe palët e interesit, si Ministria e Infrastrukturës, Menaxheri Infrastrukturës-Infracos, Ndërmarrjet Hekurudhore Trainkos dhe Railtrans. Në hartimin e disa akteve nënligjore në kuadër të ARH-së, kemi pasur mbështetje nga ekspert evropian, përmes projekteve që ARH i ka përfituar përmes programeve të BE-së, të njohura si TAIEX.¹ Po ashtu, të gjitha draft rregulloret janë dërguar për konsultim publik tek palët e interesit edhe pse të njëjtat kanë qenë pjesë e grupeve punuese. Mbi bazën e komenteve dhe rekomandimeve, ARH-ja ka përgatitur draftin final dhe të njëjtat janë aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës i ARH-së.

¹ Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit i Komisionit Evropian

Gjatë vitit 2018 ARH ka miratuar rregulloret e mëposhtme:

- Rregullorja nr. 01/2018 për Llogaritjen e Kostos Direkte; (Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2015/909 / BE);
- Rregullorja nr. 02/2018 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me Kërkesat për Marrjen e Certifikatave të Sigurisë Hekurudhore. (Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 1169/2010 / BE);
- Rregullorja nr. 03/2018 për Ndërtimin, Përmirësimin, Ripërtëritjen, Vlerësimin e Konformitetit dhe Autorizimin për Funkcionalizimin e Mjeteve Lëvizëse. (Kjo Rregullore transponon pjesërisht direktivat dhe rregulloret e BE si: 2004/49 / EC, 2008/57 / EC, 2009/131 / EC, 2008/110 / EC si dhe Rregullorja nr. 402/2013 / BE);
- Rregullorja nr 04/2018 për Caqet e Përbashkëta të Sigurisë (CST). (Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2010/409 / BE);
- Rregullorja nr. 05/2018 mbi Specifikimet Teknike për Ndërveprimin (TSI) Lidhur me Nën sistemin e Infrastrukturës. (Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së nr. 1299/2014);
- Rregullorja nr. 06/2018 për Përdorimin E Një Formati Të Përbashkët Evropian për Certifikatat e Sigurisë, Dokumentet e Aplikimit dhe Vlefshmërinë e Certifikatave të Sigurisë. (Kjo rregullore transponon rregulloren e BE-së nr. 653/2007 / EC);
- Rregullorja nr.07/2018 për Miratimin e Një Metode të Përbashkët të Sigurisë për Vlerësimin e Arritjes së Objektivave të Sigurisë. (Kjo rregullore transponon Vendimin e BE-së Nr. 2009/460 / BE); dhe
- Rregullorja nr.08/2018 për Specifikimin Teknik për Ndërveprueshmërinë (TSI) në lidhje me Nën sistemin e Operimit dhe Menaxhimit të Trafikut (OPE). (Kjo rregullore transponon Rregulloren e BE-së Nr. 2015/995).

Po ashtu gjatë vitit 2018 ne si ARH kemi marr pjesë në grupin punues të krijuar nga Ministria e Infrastrukturës për hartimin e koncept dokumentit për rregullimin e fushën për hetimin e incidenteve dhe aksidenteve hekurudhore dhe ajrore në Republikën e Kosovës.

6.2. Përmbushja e obligimeve nga agjenda e integritit evropian

Përveçse obligimit ligjor që derivon nga Ligji i Hekurudhave, ndër vite ka qenë dhe akoma vazhdon të jetë kërkesë e vazhdueshme e BE-së, e shprehur në raportet e progresit, dhe jo vetëm, që Kosova gradualisht të adoptoj dhe harmonizoj rregullat teknike për përmbushjen e kërkesave për siguri dhe interoperabilitet.

Jo vetëm në Kosovë, por edhe brenda për brenda shteteve anëtare të BE-së, për dekada me radhë transporti hekurudhore është penguar nga kufijtë dhe 'veçoritë/dallimet' kombëtare.

Iniciativa evropiane-interoperabiliteti dhe STI si rrjedhojë e saj kanë këtë qëllim, unifikimin e rregullave teknike, administrative dhe operacionale, për të formuar një kornizë të përbashkët në fushën e interoperabilitetit dhe sigurisë hekurudhore.

STI janë përgatitur dhe lëshuar në nivel të BE-së, në mënyrë që të përgatitet “hapësira unike hekurudhore evropiane” dhe si të tilla duhet të paraqesin bazën kryesore të sigurisë hekurudhore edhe në Kosovë.

Sipas Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-063, për secilin nënsistem hekurudhorë, STI në Kosovë duhet të lëshohen nga ARH-ja dhe duhet t'i plotësojnë kërkesat esenciale e në veçanti kërkesat e sigurisë.

Më qëllim të harmonizimit të legjislacionit, rregullave dhe standardeve në sektorin hekurudhor më ato të BE-së të përshtatshme për Kosovën në këtë sektor, gjatë vitit 2018 ARH i ka vënë prioritet përgatitjes së rregulloreve për STI.

Me kompleksitetin që kanë dhe me standardet e larta që bartin me vete, ka bërë që përgatitja e tyre të zgjerohej së diskutuari edhe përtej ARH-së. Renditur STI-të si akte nënligjore që hyjnë në sferën e politikave në fushën e transportit hekurudhor, bashkëpunimi me MI ishte hapi i parë që ARH bëri në këtë drejtim.

Duke njohur strukturën dhe përmbajtjen e STI dhe më pas vështirësinë e zbatimit të tyre, ARH ka zhvilluar diskutime edhe përtej nivelit nacional, përfshië opinionin që ka pranuar nga ERA (Agjensioni i Unionit Evropian për Hekurudha) dhe Shoqata e Organeve Njoftuese (përgjegjëse

për vlerësimin e nënsistemeve me STI) për formën e adaptimit të tyre. Përveçse me institucionet europiane të lartcekura, ARH ka konsultuar dhe ka marrë për bazë edhe praktikat e vendeve fqinje rreth modalitetit të adoptimit të STI-ve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, ARH gjatë vitit 2018, ka arritur që të miratoj dy rregullore nga seti i STI-ve e të cilat kanë qenë të parapara në agjendën europiane për zbatimin MSA-së.

Po ashtu, ARH ka qenë gjatë gjithë kohës në kontakt me akterët relevant në planifikimin, përgatitjen dhe raportimin e përmbushjes së obligimeve të veta legislative për vitin 2018, të cilat kanë qenë të paraqitura edhe në PKZMSA, si Ministria e Integritimit Evropian dhe ajo e Infrastrukturës. Në vazhdimësi kemi përditësuar edhe inputet për të gjitha zhvillimet në sektorin hekurudhor, për secilin kuartal veç e veç për vitin 2018, të cilat përmes Ministrisë së Integritimit Evropian, janë raportuar edhe në Komisionin Evropian.

Kurse sa i përket përgatitjes së rregullave nacionale të sigurisë, nga Agjensioni Evropian për hekurudha (ERA-European Union Agency for Railway) në Valenciennes të Francës na është thënë që të mos punohet njëherë. Kjo pasi që rregullat nacionale të sigurisë për vendet e IPA-s do të punohen me ndihmën dhe asistimin e këtij institucioni Evropian. Bazuar në këtë është propozuar që të krijohet një grup punues nga të gjitha vendet e IPA-s me qëllim të përgatitjes së rregullave nacionale të sigurisë të cilat do të vlenin për të gjitha shtetet të përfshira në programin e IPA-s. Përfaqësuesit e ARH-së në të gjitha takimet e mbajtura me ERA-n kanë ngritur nevojën e rishikimit të rregullave nacionale të sigurisë, ide kjo e mirëpritur nga ky agjension. Gjatë vitit 2019 presim që ERA do të fillojë që së bashku me vendet e IPA-s të punojë në këtë drejtim.

Gjate vitit 2018 po ashtu kemi qenë në Bruksel si pjesë e komitetit ekzekutiv 'Infrastruktura' për të raportuar para Komisionit Evropian, për sektorin hekurudhor. Pas raportimit dhe diskutimeve me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, kanë dalë tri konkluzione:

- Vazhdimi i punës në 'shtyllën teknike' e cila është edhe pjesë e Paketës së Katërt Hekurudhore;
- Vazhdimi i punës në Rregullat Nacionale të Sigurisë dhe Interoperabilitetit, si dhe
- Vazhdimi i punës për njohjen reciproke të licencave të makinistëve.

Vlenë të cekët se përmbushje e suksesshme e obligimeve legislative nga agjenda evropiane e Kosovës nga ana e ARH-së, ka pasur impakt pozitiv edhe në vlerësimin përfundimtar të bërë për institucionet e Republikës së Kosovës nga ana e Bashkimit Evropian.

6.2.1. Kërkesat e legjislacionit të BE-së për mandatin dhe pavarësinë institucionale të ARH-së

Në kuadër të agjendës së Qeverisë së Kosovës për reformë në administratën shtetërore, reforme kjo që prek edhe agjencitë rregullatore të pavarura, siç është ARH, ne kemi përgatitur shkresën për Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkitazi me këtë çështje, konkretisht draft ligjin për riorganizimin e agjencive të pavarura, ku si ARH kemi shprehur qëndrimet tona se pse duhet të mbesim me funksion rregullator dhe nen mbikëqyrjen e Kuvendit.

Në këtë kërkesë tonë si ARH, kemi potencuar faktin se ARH që nga vitit 2013 është anëtare me të drejta të plota në Grupin e Pavarur të Rregullatorëve Evropian, e njohur si IRG-rail dhe se njeri nga kriteret baze për anëtarësim dhe qëndrim në këtë mekanizëm të rëndësishëm Evropiane, është që ARH të mbetet e pavarura nga Qeveria dhe degët e sajë ekzekutive siç janë Ministrinë. Në këtë linjë të kërkesave për pavarësi institucionale të rregullatorit hekurudhor janë edhe Agjencia Evropiane e Hekurudhave si dhe mekanizmat tjerë evropian që merren me rregullimin e fushës hekurudhore.

Poashtu, edhe Direktivat e BE-së të cilat specifikisht rregullojnë fushën e hekurudhave e ku ARH është përgjegjëse, siç janë: Direktiva e BE-së 2012/34, Direktiva e BE-së 2004/49, Direktiva e BE-së 2008/57 e kërkojnë në mënyrë eksplicite që ARH të jetë e pavarur nga institucionet ekzekutive, ministrinë.

6.3. Përfaqësimet Ligjore për aksidente hekurudhore

Gjatë vitit 2018 përfaqësuesit ligjorë të ARH-së kanë marrë pjesë në dy konteste gjyqësore që kanë të bëjnë me aksidente hekurudhore. Rasti i parë C.nr.1145/15 është rasti i aksidentit hekurudhor i vitit 2012 me fatalitet, i ndodhur në vijën hekurudhore Prishtinë – Pejë, në vendin e quajtur Vneshtat, Zahaq KK-Pejë. Fatkeqësisht ky aksident ka përfunduar me fatalitet dhe dëme materiale. Në këtë kontest gjyqësor, ARH ka qenë njëra nga palët e paditura. Gjatë vitit 2018 përfaqësuesit ligjorë të ARH-së kanë marrë pjesë në të gjitha seancat e mbajtura gjyqësore. Bazuar në super-ekspertizën gjyqësore të bere për këtë rast, përgjegjësia ka qenë e ndarë mes drejtuesit të mjetit lëvizës traktor, e që në këtë rast ka qenë viktima, dhe mos-pastrimit të vijës hekurudhore në nivelin e duhur nga ana e Infrakos-it, i cili menaxhon me infrastrukturën hekurudhore. Të njëjtën gjë e ka pohuar edhe Gjykata Themelore e Pejës – Departamenti i Përgjithshëm me Aktgjykimin C.nr.1145/15, dt.29.11.2018, duke konkluduar se gjerë të aksidenti i ndodhur, ka ardhur si pasojë e vozitjes së pa sigurt dhe shpejtësisë të papërshtatshme për kushtet e rrugës me rastin e kalimit të binarëve të trenit.

Gjykata e lartcekur ka marrë për bazë argumentet e ARH-së të paraqitura gjatë seancave gjyqësore dhe me shkrim në këtë rast, në këtë mënyrë duke mos e ngarkuar me asnjë lloj përgjegjësie për aksidentin në fjalë.

Rasti i dytë është rasti C.nr.1111/13, edhe ky aksidenti i ndodhur po ashtu në vijën hekurudhore Pejë – Fushë Kosovë në vendin e quajtur Zahaq- Llabjan. Ky aksident i ndodhur përpos dëmeve materiale nuk ka pasur viktimë. ARH edhe në këtë rast është njëra nga palët e paditura. Në bazë të dy ekspertizave profesionale gjyqësore të bëra nga dy ekspertë të kësaj fushe në këtë rast, ARH nuk del të ketë ndonjë përgjegjësi për të cilën ka ndodhur aksidenti në fjalë. Në këtë kontestgjyqësor janë mbajtur disa seanca gjatë vitit 2018, ku përfaqësuesit ligjorë të ARH-së kanë marrë pjesë, porse ky rast vazhdon të jetë ende në trajtim e sipër në Gjykatën Themelore të Pejës. Bazuar në konkludimet e dy ekspertizave të kryera për këtë aksident si dhe argumenteve ligjore të parashtruara nga ARH, jemi të bindur se Gjykata ngjashëm sikurse në rastin paraprak, do të bjerë vendim meritor dhe të bazuar se ARH nuk ka përgjegjësi për aksidentin në fjalë.

6.4. Inspektimet

6.4.1. Inspektimi i makinistëve

Në kuadër të inspektimit të licencave, ARH sipas vlerësimeve të veta dhe nevojës, gjithashtu bënë inspektime të paparalajmëruara në terren për makinistët të cilët drejtojnë trenat brenda territorit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtyre inspektime është verifikimi, nëse trena në Kosovë drejtohet vetëm nga makinistët e licencuar. Vlen të theksohet, se që nga licencimi i parë i makinistëve i bere nga ARH-ja në vitin 2015, nga të gjitha inspektimet në terren, përfshi edhe ato te realizuara gjate vitit 2018, ka rezultuar se trenat drejtohen vetëm nga makinist të licencuar. Gjatë vitit 2018 ARH ka realizuar dy inspektime të kësaj natyre në teren, një në linjën hekurudhore Prishtinë-Pejë, ndërsa tjetrën në linjën Prishtinë-Hani Elezit. Në të dy rastet ka rezultuar se trenat kanë qenë duke u drejtuar nga makinist të licencuar nga ARH-ja.

6.4.2. Inspektimi i Infrastrukturës Hekurudhore

ARH në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore të parapara me Ligjin Nr. 04/L-063 neni 19 paragrafi 6, 104 paragrafi 5, si dhe në përputhje me planin e punës për vitin 2018, ka kryer inspektimin e të gjitha linjave hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it, si dhe ka përgatitur raportin për të gjitha linjat e inspektuara. Gjatë procesit të inspektimit janë marrë parasysht të gjithë faktorët të cilët direkt apo indirekt kanë ndikim në sigurinë hekurudhore. Ne për secilën linjë të inspektuar kemi përgatitur një raport me të gjeturat kryesore gjatë inspektimit. Në raport janë përfshirë disa nga të gjeturat për te cilat ne kemi menduar se janë me të rëndësishme. Gjatë inspektimeve të kryera në vitin 2018 kryesisht jemi fokusuar në inspektimin e vendkalimeve hekurudhore, pasi që në vendkalime po ndodhin pothuajse të gjitha aksidentet dhe incidentet hekurudhore.

Linjat e inspektuara janë:

1. Prishtinë-Fushë Kosovë, 9 vendkalime legale si dhe 7 vendkalime ilegale.
2. Fushë Kosovë - Magure,
3. Klinë-Prizren, 52 vendkalime legale.
4. Prishtinë-Podujevë, 20 vendkalime legale si dhe 6 vendkalime ilegale.
5. Fushë Kosovë-Mitrovicë, 31 vendkalime legale.

6. Fushë Kosovë-Pejë, 76 vendkalime legale si dhe 14 vendkalime ilegale.
7. Fushë Kosovë-Hani i Elezit, 52 vendkalime legale, 6 vendkalime legale të përkohshme si dhe 5 vendkalime ilegale.
8. Terminali i mallrave Miradi.

Në raportet e përgatitura kemi paraqitur mangësitë të cilat ekzistojnë në secilën linjë veç e veç por kemi evidentuar edhe punët të cilat janë kryer nga ana e kompanisë Infrakos. Gjatë inspektimit të linjave kemi konstatuar se është punuar në mirëmbajtjen e gjeometrisë së linjave, balastit, ndërrueseve, sinjalizimit në stacione dhe traversave. Shqetësuese për ne mbetet sinjalizimi dhe sigurimi i vendkalimeve. Në këtë pjesë ne mendojmë që duhet të punohet më shumë. Shumë vendkalime shtrihen në vendbanime ku frekuentimi nga ana e banorëve dhe automjeteve është mjaft i madh, në disa pjesë ka mungesë qoftë të sinjalizimit me shenja të komunikacionit rrugor, sigurim me semafor apo barriera (rampë). Ne mendojmë se këto vendkalime janë pikat me të rrezikshme të identifikuar nga ana e jonë.

6.4.3. Inspektimi i Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore

Gjatë viti 2018, ARH ka kryer inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë në menaxhim apo pronësi të Infrakos, Trainkos, Railtrans dhe NewCo Ferronikeli Complex LLC, që janë të autorizuar për tu futur në shërbim nga ana e ARH-së.

Janë inspektuar këto parametra të sigurisë: Dimensionet e profilit të rrotave, trashësia e rrotave, papuçet e frenimit, sistemi i frenimit, hapja dhe mbyllja e dyerve, sistemi i ndriçimit, buria dhe radio lidhja, lidhëset e ajrit, çengeli etj.

Për të gjitha këto mjete lëvizëse hekurudhore është përgatitur nga një raport, ku kemi paraqitur të gjeturat gjatë procesit të inspektimit.

Bashkëngjitur me këtë raport është paraqitur edhe raporti i inspektimit të këtyre mjeteve lëvizëse të cilat përdoren për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore.

6.4.4. Inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse

Bazuar në punën dhe përgjegjësit e veta që ka ARH, në baza vjetore realizon inspektimin e regjistrimit të mjeteve lëvizëse.

Kete vit inspektimit NVR iu nënshtruan mjetet lëvizëse të Trainkos-it, Infrakos-it, Railtrans-it dhe mjetet lëvizëse të NeëCoFerronikeliComplex LLC

Janë inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore me të cilat operojnë ndërmarrjet hekurudhore brenda territorit të Kosovës, për të kontrolluar nëse ato janë të regjistruara, ashtu siç përcaktohen me rregulloren e regjistrimit 05/2012.

Ligjërisht të gjitha mjetet hekurudhore të vendosura në shërbim, duhet t'i përcaktohet një numër identifikues unik dymbëdhjetë shifrore, i njohur si Numri Evropian i Mjetit Lëvizës (EVN), i cili duhet të jetë i shfaqur/shënuar në secilin mjet lëvizës. Përveçkësaj mjetet lëvizëse duhet ta vënë në dukje edhe kompaninë të cilës i përkasin. Kjo realizohet përmes shënimit të kodit VKM (Shënimit i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës), i cili është pasqyrim i emrit të plotë apo shkurtësës së mbajtësit të mjetit lëvizës.

Për t'u siguruar që ndërmarrjet hekurudhore aplikojnë këtë obligim ligjorë, ARH në baza vjetore krahas inspektimit NVR, realizon edhe inspektimin e EVN-së dhe VKM

Mbështetur nga te gjeturat e inspektimeve janë përgatitur raportet me rekomandime për kompanitë e cekura më lartë. Raportet e finalizuar janë dërguar në të gjitha kompanitë.

Tabela 3. Kompanitë hekurudhore dhe Kodi i VKM-së

	VKM	UNIKE	STATUS		
Sqarime:	Kodi që shihet në mjetin lëvizës	Kontrollimi i kodeve unike	Blokuar	Në përdorim	Revokuar
VKM	UNIKE	Emri i VKM	Shteti	Statusi	Webfaqja
IHK	IHK	INFRAKOS	KS	Në përdorim	www.kosovorailway.com
NCF	NCF	NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C	KS	Në përdorim	www.cunicoresources.com
TRKOS	TRKOS	TRAINKOS	KS	Në përdorim	www.trainkos.com
RT	RT	RAILTRANS	KS	Në përdorim	www.railtrans.biz

6.5. Monitorimet

6.5.1. Monitorimi i licencave

Gjatë vitit 2018 ARH kryesisht ka monitoruar licencat e lëshuara ndër vite, e të cilat gjithsej janë 33. Monitorimi i Licencës të Menaxherit të Infrastrukturës-Infracos dhe licencat për Ndërmarrjet Hekurudhore Trainkos dhe Railtrans, kryesisht ka qenë i përqendruar tek polica e sigurimit në raport me palët e treta, si mbulueshmërisë në rast të incidentit apo aksidentit hekurudhor brenda për brenda Kosovës. Ngjajshëm sikurse në vitet paraprake, ne si ARH edhe gjatë vitit 2018 kemi kërkuar në vazhdimësi që ky kusht të plotësohet pa ndërprerje, duke ju rikujtuar kohë pas kohe këtë detyrim ligjorë ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës, përkundër faktit se një gjë e tillë është në përgjegjësinë direkt të tyre. Mirëpo, pavarësisht angazhimit tonë të vazhdueshëm në këtë pikë edhe pse e gjithë përgjegjësia është tek kompanitë e licencuara që të sjellin në kohë sigurimin e kompanisë, në disa raste po ka vonesa në veçanti kompanitë publike. Sipas arsytimit zyrtar të tyre, këto vonesa po ndodhin për shkak të procedurave të prokurimit, përmes të cilave duhet të shkoj ky proces dhe sa ka pas raste ku përkundër fatit që Infracos ka shpallur tender për sigurim te kompanisë, nuk ka pas oferta.

Po ashtu, në kuadër të monitorimit të licencave të makinistëve të licencuar, hyjnë edhe raportet mjekësore periodike nga institucionet shëndetësore kompetente, të cilat i kërkon ARH-ja. Bazuar në legjislacionin pozitiv në Kosovë, makinistët mbi moshën 55 vjeçare, këto raporte mjekësore duhet t'i sjellin në baza të rregullta vjetore, kurse makinistët nën moshën e lartcekur, një herë në tre vite. Edhe gjatë vitit 2018 ARH ka pranuar raportet mjekësore nga ndërmarrjet hekurudhore për makinistët e tyre të licencuar.

Në vazhden e monitorimit të licencave të makinistëve, në vitin 2018, ARH ka përpiluar dhe dërguar një shkresë zyrtare tek ndërmarrjet hekurudhore të cilat kanë makinistë të licencuar, si Trainkos dhe Railtrans, përmes së cilës ju është kërkuar që pavarësisht vlefshmërie që mund të kenë licencat e makinistëve në kohen kur ata të arrijnë moshën 65 vjeçare, të respektojnë legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me kushtet dhe moshën e pensionimit të makinistëve.

6.5.2. Monitorimi i tregut hekurudhor

ARH, në kuadër të kompetencave ligjore, njëhën nga përgjegjësitë kryesore, e ka monitorimin e tregut hekurudhor në vend. Në kuadër të kësaj përgjegjësie, ARH ka monitoruar tregun hekurudhor në Republikën e Kosovës. Pas monitorimit është përgatitur raport i veçantë për monitorimin e tregut, ku në detaje ka paraqitur të dhënat e gjetura nga tereni dhe nga burime të ndryshme të informacionit prej entiteteve që merren me statistika dhe analiza të transportit në përgjithësi. Të gjeturat e Raportit të Monitorimit të Tregut për veç se i shërbejnë ARH-së dhe sektorit hekurudhor brenda për brenda Kosovës, të njëjtat raportohen në periudha vjetore edhe në Grupin e Rregullatorëve të Pavarur Evropian – IRG Rail, ku ARH që nga viti 2013 është anëtare me të drejta të plota.

Të dhënat e monitorimit të dërguara nga ARH, më pastaj përmbledhen dhe publikohen nga ky mekanizëm evropian, në një raport të veçantë ku përfshihen të dhënat e monitorimit të tregut hekurudhor për tërë Bashkimin Evropian dhe më gjerë.

Qëllimi i raportit të monitorimit është mbledhja e sa më shumë të dhënave për tregun hekurudhor, në mënyrë që këto dhëna t'i vë në shërbim të funksionimit më të mirë të sektorit hekurudhor. Monitorimi i tregut është një instrument dhe mekanizëm i rëndësishëm i cili mund të kontribuoj në rritjen e cilësisë së shërbimeve në transportin hekurudhor, po ashtu raporti i monitorimit të tregut mund të shërbej si një dokument i rëndësishëm që paraqet zhvillimin e tregut hekurudhor në vend për të gjitha palët e interesit.

Dokumenti në të cilin përcaktohen treguesit e monitorimit të tregut, është i të njëjtit format me atë të IRGRail, për monitorimin e tregut hekurudhor, i cili është i njëjti për të gjithë rregullatorët të cilët janë të anëtarësuar.

6.6. Ekspozeu i Rrjetit 2019

ARH, gjatë vitit 2018, ka bërë pranimim, shqyrtimin, analizimin, komentimin dhe ka dhënë rekomandimet në draft Ekspozeun e Rrjetit 2019, i cili është përgatitur nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore InfrakosSh.A. Lidhur me këtë, kemi mbikëqyrë procesin konsultimeve mes palëve të interesit, siç janë: Infrakos, Trainkos, Railtrans, MI, MZHE. Si temë specifike ka qenë kapitulli i gjashtë (6) i Ekspozeut të Rrjetit me përshkrimin, shërbimet

e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, pra mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos.

ARH, ka pranuar ankesë nga ana operatorëve hekurudhore lidhur me lartësinë e tarifave të propozuara nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore. Pas shqyrtimit të ankesave dhe fakteve të paraqitura se bashku me ankesat e lartcekura, ARH ka arritur në përfundim se çmimet e propozuara janë të larta për kushtet e tregut në Kosovë si dhe krahasuar me vendet e rajonit dhe si rezultat ka rekomanduar uljen e tarifave të propozuara.

Marrë për bazë, opinionin e ARH-së, Ministria e Infrastrukturës, ka aprovuar çmime më të ulëta nga ato të propozuara fillimisht në Ekspozeun e Rrjetit 2019.

6.7. Aplikime të reja

6.7.1. Licenca

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2018, ARH-ja ka pranuar një aplikacion të ri për licencë për makinist. ARH brenda afateve të papara ligjore ka bërë shqyrtimin dhe vendosjen për këtë aplikacion për licence. Gjate shqyrtimit, përveç respektimit të procedurave ligjore të parapara, shqyrtimi i këtyre aplikacioneve nga ana e ARH-së është bërë konform procedurave dhe kërkesave ligjore në fuqi, të parapara me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës si dhe Rregullores për Licencimin e Makinistëve Nr .02/2013. ARH gjatë shqyrtimit të aplikacioneve është fokusuar në kushtet të cilat Ligji dhe Rregullorja i obligon që një makinist t'i përmbushë, në mënyrë që të marrë licencë. Këto kushte kanë qenë: Certifikata e Makinistit e lëshuar nga vetë ndërmarrja hekurudhore, ekzaminimi mjekësor konformë kërkesave të parapara në Ligj dhe Rregulloren për Licencimin e Makinistëve si dhe kualifikimi shkollor, që nënkupton përfundimin e shkollës së mesme. Vendimi i ARH-së për aplikacionin, rrjedhimisht kërkesën për licencë makinisti ka qenë pozitiv.

Ndërsa sa i përket aplikimeve për licence për transport të udhëtareve apo mallrave nuk ka pasur ndonjë aplikacion, as nga kompanitë vendore apo ato ndërkombëtare. Bazuar në Ligji për Hekurudhat e Kosovës, tregu hekurudhor është i liberalizuar dhe se kompani të ndryshme të jashtme mund të aplikojnë për licencë të re apo njohje të saj. Vlen të theksohet se në vitet paraprake, ka pasur interesim nga kompani të huaja, të cilat janë interesuar për procedurat e

njohjes së licencës Evropiane për transport hekurudhor të mallrave. Duke ju përgjigjur këtyre kërkesave për interesim, ne si ARH i kemi informuar rreth kriterëve, procedurave si dhe afateve ligjore, që duhet të plotësohet nga një ndërmarrje e caktuar në mënyrë që të pajisen me licencë. Meqenëse tek njohja e licencës Evropiane ka qene një paqartësi ligjore rreth kushteve dhe kriterëve për njohjen e kësaj licence, ne si ARH e kemi ngritur dhe adresuar tek Ministria e Infrastrukturës këtë çështje, së bashku me rekomandime konkrete. Si rezultat, Ministria e Infrastrukturës ka amendamentuar Udhëzimin Administrative Nr. 02/2012 me Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2017, ku mes tjerash ka plotësuar në mënyrë specifike të gjitha procedurat dhe kriteret për njohje të licencës Evropiane. Ne grupin punues për plotësim ndryshimin e këtij Udhëzimi Administrativ ka qenë edhe ARH-ja, kështu duke dhënë kontributin e vete profesional, përkitazi me këtë çështje.

6.7.2. Autorizimi i sigurisë

Gjatë vitit 2018 kemi pasur një aplikim për të rinovuar Autorizimin e Sigurisë pjesa A dhe B. Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore të Kosovës Infracos Sh.A me datë 27.03.2018 ka aplikuar në ARH, për të marrë një Autorizim të rinovuar të Sigurisë Pjesa A dhe B. Pas shqyrtimit dhe analizimit të te gjithë dokumentacionit të ofruar me rastin e aplikimit si dhe konformë dispozitave ligjore në fuqi Ligjit për hekurudha si dhe rregulloreve të ARH-së të miratuara për procesin e marrjes së autorizimit të sigurisë, ARH me datë: 30.03.2018 ka vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe kemi vendosur që të lëshojmë Autorizim e Sigurisë pjesa A dhe B.

6.7.3. Certifikata e sigurisë

Gjithashtu gjatë vitit 2018 kemi pasur një aplikim për të rinovuar Certifikatën e Sigurisë pjesa A dhe B.

Operimet me Trena të Hekurudhave të Kosovës respektivisht ndërmarrja hekurudhore Trainkos Sh.A me datë: 28.03.2018 ka aplikuar të Autoriteti Rregullativ Hekurudhave për të marrë një për Certifikatë të Sigurisë të rinovuar pjesa A dhe B. Pas shqyrtimit dhe analizimit të te gjithë dokumentacionit të ofruar me rastin e aplikimit si dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi Ligjit për hekurudha si dhe rregulloreve të ARH-së të miratuara për procesin e marrjes së certifikatës së rinovuar të sigurisë Pjesa A dhe B. ARH me datë: 30.03.2018 ka vlerësuar se të

gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe ka vendosur që të lëshojë Certifikatën e Sigurisë pjesa A dhe B.

6.7.4. Shqyrtimi i aplikacioneve për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse

Gjatë vitit 2018 nuk kemi pranuar asnjë kërkesë qoftë nga menaxheri i infrastrukturës apo operatorët me trena për marrjen e ndonjë autorizimi për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse

6.7.5. Njohja e Licencave për Makinist

Një nga kërkesat e Bashkimit Evropian për sektorin hekurudhor në Kosovë, respektivisht institucionet relevante është njohja reciproke e licencave të makinistëve mes Republikës së Kosovës dhe vendeve tjera. Ne si ARH e kemi ngritur këtë çështje zyrtarisht tek Ministria e Infrastrukturës, pasi që një përgjegjësi e tillë bie mbi këtë të fundit në kuptim të nenit 8 paragrafi 2 të Ligjit të Hekurudhave, meqenëse hyn në kuadër të politikave të transportit hekurudhor. Në takimet zyrtare të realizuara gjatë vitit 2018 jemi njoftuar nga Ministria se draft Udhëzimi Administrativ përmes se cilit synohet që të rregullohet njohja reciproke e licencave të makinistëve veçse ekziston, por i cili sipas agjendës legjislative të Ministrisë është paraparë që të miratohet gjatë vitit 2019. Ne si ARH kemi shpreh gatishmërinë tonë që të japim kontributin tonë profesional lidhur me këtë çështje, kurdo që Ministria e vlerëson të nevojshme dhe e kërkon një gjë të tillë.

6.8. Azhurnimi i Regjistrave

6.8.1. Regjistri i Licencave në kuadër të ARH-së

Është kërkesë ligjore që ARH të mbaj dhe azhurnoj regjistrat për të gjitha llojet e licencave të lëshuara. Duke ju përgjigjur kërkesave ligjore të lartcekura, ne si ARH kemi krijuar dhe azhurnojmë rregullisht, të gjithë regjistrat ekzistues për të gjitha llojet e licencave. Qëllimi i këtyre regjistrave është që çdo person fizik apo juridik, i cili ka nevojë dhe interes të ketë informacione për sektorin hekurudhore në Republikën e Kosovë, një gjë të tillë mund ta bëjë në mënyrë shumë të lehtë dhe praktike në ueb faqen e ARH-së. Ne si ARH, kujdesemi gjithashtu, në një rën anë, që këta regjistra të mos përmbajnë informacione të natyrës

konfidenciale, e që do mund të dëmtonte ndërmarrjet e licencuara, dhe se në anën tjetër, të mos ekspozohen të dhënat personale më tepër se sa lejon korniza ligjore në fuqi.

6.8.2. Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave

Gjatë viteve të fundit Zyra Ligjore e Kryeministrit ka koordinuar procesin e krijimit dhe azhurnimit të Regjistrit Qendror për Leje dhe Licenca, i cili përmbledh të gjitha lejet dhe licencat e lëshuara në nivel nacional, përfshi edhe ato të lëshuara nga ARH. Edhe gjatë vitit 2018, ARH ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën Ligjore të Kryeministrit lidhur me përditësimin e regjistrit qendror për leje dhe licenca, ku në si ARH kemi ofruar të gjitha informatat e nevojshme dhe të përditësuara për këtë regjistër qendror. Sipas kërkesës së Zyrës Ligjore të Kryeministrit kemi dërguar, mes tjerash: formularët për aplikim për Licenca për Menaxher të Infrastrukturës, Ndërmarrje Hekurudhore si dhe Makinist, bazën ligjore të këtyre licencave dhe të akteve nënligjore, afatet kohore, taksat ose pagesat për këto lloje licenca. Po ashtu në këtë regjistër të dhënat e ngjashme janë dërguar edhe për pjesën e autorizimit të sigurisë, certifikatës së sigurisë si dhe autorizimit për futje në shërbim të mjeteve lëvizëse.

Funksionalizimi dhe avancimi i regjistrit në fjalë, ka qenë i mbështetur nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, si Banka Botërore, Corporata Financiare Ndërkombëtare dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, në kuadër të Projektit “Klima e Investimeve në Kosovë II”.

6.9. Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse (NVR)

Në përputhje me kërkesat që dalin nga korniza ligjore nacionale, ARH është e obliguar të krijojë dhe azhurnojë regjistrin ad-hoc me të gjitha informatat e nevojshme të mjeteve lëvizëse hekurudhore të regjistruara, referuar si Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse (NVR).

Për çdo mjet të regjistruar në NVR ka disa parametra të informacionit që përbëjnë kërkesat minimale të përmbajtjes së regjistrit: Regjistri nacional i mjeteve lëvizëse hekurudhore ofron informacion mbi.

- pronarin e mjetit;
- vitin e prodhimit.
- mbajtësin/administruesin e mjetit lëvizës

- entitetin përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse;
- autorizimet e marra për vendosjen në shërbim;
- kufizimet në përdorimin e automjeteve, etj;

Regjistri nacional i mjeteve lëvizëse hekurudhore siguron qasje në informatat kyçe në lidhje me mjetet hekurudhore që operojnë në rrjetin e hekurudhave të Kosovës. Detyrimi i regjistrimit vlen për të gjitha mjetet hekurudhore që kanë një autorizim për futje në shërbim.

Të drejte qasjeje në NVR, kanë vetëm organet e përmendura në nenin 110 (8.3) të ligjit për hekurudha dhe në piken 3.3 në anex të Vendimit 2011/107/EU.

6.10. Aktivitetet për rritjen e nivelit të sigurisë hekurudhore

Duke marrë për bazë numrin e aksidenteve hekurudhore të cilat kanë ndodhur në vitet paraprake, si dhe me qëllim të sensibilizimit të opinionit, ARH ka ndërmarr aktivitete të shumta që përfshinë vizitat dhe takimet më udhëheqës komunal në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, në të cilat shtrihet linja hekurudhore e të cilat janë në përdorim.

Përmes këtyre takimeve është synuar që fillimisht të arrihet një bashkëpunim në mes të ARH-së dhe këtyre komunave, i munguar deri me tani, si dhe sqarimi i detyrave dhe përgjegjësive të Komunave përkatëse në raport me Ligjin për Hekurudha. Kjo iniciativë është mirëpritur dhe vlerësuar lartë nga autoritetet komunale, duke ofruar gatishmërinë e plotë për bashkëpunim me ARH-në me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë hekurudhore.

Realizimi i këtij projekti ka ndikuar në krijimin e një praktike të re të bashkëpunimit ndërinstytucional, e cila ka ndikuar në nxitjen e planifikimit të aktiviteteve tjera të përbashkëta në të ardhmen, me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë që do të ndikonte në parandalimin e aksidenteve hekurudhore.

Në aspektin e sigurisë, gjatë këtyre takimeve, diskutime kishte posaçërisht për përgjegjësitë ligjore (Ligji për Hekurudhat) si dhe sqarimin e këtyre përgjegjësive në mes të Ministrisë, komunave, Menaxherit të Infrastrukturës dhe akterëve tjerë. Në kuadër të kësaj, me theks të veçantë është diskutuar çështja e vendkalimeve hekurudhore, legale dhe ilegale, sinjalizimi, aksidentet hekurudhore, pastrimi i brezit hekurudhor etj.

Siç u theksua edhe më lartë, këto takime janë realizuar në komunat nëpër të cilat shtrihet linja hekurudhore, që përfshinë komunat: Hani i Elezit, Kaçanik, Ferizaj, Lipjan Fushë Kosovë, Prishtinë, Obiliq, Drenas, Klinë dhe Pejë.

Përfaqësuesit e ARH-së dhe autoritetet e komunave të lartpërmendura kanë shprehur gatishmëri për bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitucional në trajtimin e çështjeve me interes të përbashkët, veçanërisht në çështjet e sigurisë hekurudhore.

6.10.1. Raporti Vjetor i Sigurisë

Siç parashihet edhe me Ligjin Nr. 04/L-063 neni 20 paragrafi 1 organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore duhet të përpiloj raportin vjetor në lidhje me sigurinë të cilin ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të ARH-së. Ky raport duhet të përfundohet dhe dorëzohet deri në fund të shtatorit të vitit vijues (e jo siç thuhet në paragrafin 1 deri në fund të janarit të vitit vijues), si dhe direktivës Nr. 2004/49/EC, dhe neni 18.

Gjithashtu sipas ligjit Nr. 04/L-063, neni 103, paragrafi 6 thotë: Çdo vit, të gjithë menaxheret e infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjet hekurudhore (NH) para 30 qershorit duhet të paraqesin raportin vjetor të sigurisë në lidhje me vitin kalendarik të mëparshëm të organi përgjegjës për sigurinë, gjithashtu përgatitja e raportit vjetor të sigurisë është e paraparë edhe në direktivën Nr. 2004/49/EC, nenin 9 paragrafi 4.

Raporti vjetor i përgatitur nga organi i sigurisë hekurudhore, ky raport është i bazuar në të dhënat e dorëzuara në raportet e sigurisë të MI dhe NH, si dhe nga aktivitetet e organit të sigurisë nga viti 2017.

Raporti përshkruan të gjitha informatat e sigurisë e që kanë të bëjnë me sigurinë hekurudhore, ndryshimet në legjislacion, zhvillimet në certifikatën e sigurisë dhe autorizimit të sigurisë, raportet nga mbikëqyrja e menaxherit të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse etj.

Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore Infrakos, me datë: 28.06.2018 ka dorëzuar në ARH raportin vjetor të sigurisë për vitin 2017.

Ndërmarrja hekurudhore Trainkos, me datë: 26.06.2018 ka dorëzuar në ARH raportin vjetor të sigurisë për vitin 2017.

Ndërmarrja hekurudhore Railtrans, me datë: 28.06.2018 ka dorëzuar në ARH raportin vjetor të sigurisë për vitin 2017.

Bazuar në raportet vjetore të menaxherit të infrastrukturës, dy ndërmarrjeve hekurudhore si dhe bazuar në informatat e mbledhura nga aktivitetet e organit të sigurisë gjatë vitit 2017, ne me datë: 28.09.2018, kemi përgatitur raportin vjetor të sigurisë të cilin e kemi dërguar te Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

6.10.2. Azhurnimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vendore rreth HK-së

Bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të arritura në mes të institucioneve dhe kompanive në sektorin hekurudhor, ARH ka të krijuar listën e marrëveshjeve ndërkufitare e cila gjatë vitit azhurnohet përmes marrëveshjeve të reja ose atyre që pësojnë ndryshime. Në listë janë të përfshira edhe marrëveshjet vendore të menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore mbi operimin dhe mirëmbajtjen. Me kërkesë të ARH-së palët nënshkruese njoftojnë ARH-në mbi marrëveshjet e nënshkuara, të cilat i bashkëngjiten listës së këtyre marrëveshjeve.

Azhurnimi i fundit është realizuar në muajin dhjetor 2018, si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes në mes të Operatorit me Trena TRAINKOS dhe NEWCO FERRONIKELI COMPLEX LLC.

1. Marrëveshje për transportin hekurudhor , nënshkruar më dt: 27.08.2018.
2. Marrëveshje për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore, nënshkruar më dt: 27.08.2018.

Informacione të detajuara mbi marrëveshjet gjinden në tabelën e më poshtme.

Tabela 4. Marrëveshjet ndërkombëtare dhe vendore Hekurudhore të Kosovës

Nr.	Marrëveshjet	Palët nënshkruese	Data e nënshkrimit	Komentet
1	Marrëveshja e përkohshme ndërmjet NHT”BEOGRAD” dhe HEKURUDHAT E UNMIK-ut të	HEKURUDHAT E UNMIK-ut - NHT”BEOGRAD”	31.05.2002 - nuk implementohet	Nuk zbatohet që nga 03.03.2008, si pasojë e masave të ndërmarra nga entitetet lokale të pjesës Veriore të vendit pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës.

2	Marrëveshja e përkohshme në mes HEKURUDHAT MAQEDONE dhe HEKURUDHAT E UNMIKU-ut	HEKURUDHAT E UNMIKU-ut - HEKURUDHAT MAQEDONE	30.08.2002	Transporti hekurudhorë ndërmjet dy shteteve respektive, Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës ende bëhet sipas kësaj Marrëveshje. Rezultat i Marrëveshjes kornizë të datës 15.09.2011 është Marrëveshja implementuese për ndërlidhjen e përbashkët të rrjeteve Hekurudhore ndërmjet Hekurudhave të Maqedonisë-Infrastruktura dhe Hekurudhave të Kosovës e nënshkruar me datën 15.02.2016 për të cilën ende nuk është krijuar baza për zbatim.
3	Marrëveshja ndërmjet , Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi komunikacionin hekurudhor kufitar	Qeveria e Republikës së Kosovës – Qeveria e Republikës së Maqedonisë	15.09.2011	Kjo është kontratë kornizë dhe bazohet në Traktatin për transport. Pritet finalizimi i marrëveshjeve të palëve në fushat e veçanta: hekurudha, polici, dogana dhe shërbimet fitosanitare.
4	Marrëveshja për mirëmbajtje të binarit industrial	“NEW CO FERRONIKELI COMPLEX LLC” - “INFRAKOS” SH.A.	27.02.2012	Kontrata e nënshkruar më 27.02.2012 ka të precizuar kohën e paralajmërimit të shkëputjes së kontratës dhe është implementuar .
5	Marrëveshja ndërkombëtare për kalimin ndërkufitar ndërmjet “INFRAKOS”SH.A. – Kosovë dhe H.M. ”INFRASTRUKTURA” - Maqedoni	“INFRAKOS” SH.A. – H.M. “INFRASTRUKTURA”	Pa-finalizuar	Kjo marrëveshje është finalizuar dhe është nënshkruar nga “INFRAKOS”SH.A. – Kosovë dhe H.M. ”INFRASTRUKTURA” - Maqedoni Implementimi i sajë mund të filloj pasi të nënshkruhet kjo marrëveshje edhe nga Policia Kufitare dhe organi Fito-sanitar, etj., të te dy shteteve.
6	Marrëveshja ndërmjet TRAINKOS SH.A. dhe	TRAINKOS SH.A. - INFRAKOS SH.A.	24.08.2015	Kontrata e nënshkruar më 24.08.2015 ka të precizuar kohën e paralajmërimit të

	INFRAKOS SH.A. për shërbime te përbashkëta			shkëputjes së kontratës dhe mund të shtohet me aneks të ndonjë pike/çështje të nevojshme. Kjo Marrëveshje vazhdon të zbatohet edhe në vitin 2018.
7	Marrëveshja për qasjen në binarë "IFRAKOS"SH.A. dhe "TRAINKOS"SH.	TRAINKOS SH.A. - INFRAKOS SH.A.	Pa-finalizuar	Kjo Marrëveshje në kohën e raportimit (06.11.2018) është në shqyrtim të ndërsjellë për të u finalizuar dhe nënshkruar nga të dyja palët. Zbatimi i Marrëveshjes dhe faturimi i shërbimit bëhet sipas "Ekspozeut të rrjetit për vitin 2018" të lëshuar nga INFRAKOS Sh.A. pas harmonizimeve dhe aprovimit nga Ministria e Infrastrukturës. Marrëveshja që do të nënshkruhet nga dy palët do të jetë e vlefshme për pjesën e mbetur të vitit 2018 dhe për vitin 2019.
8	Marrëveshja për transport të mallrave ndërmjet "NEW CO FERRONIKELIN COPLEX LLC dhe TRAINKOS Sh.A.	"NEW CO FERRONIKELIN COPLEX LLC" - TRAINKOS Sh.A.	E nënshkruar 27.08.2018	Për shkak të oscilimeve dhe ndërrimeve të pronësisë së kompanisë "NewCo Ferronikeli LLC" kontrata dhe transporti (vëllimi) kanë ndryshuar dhe kanë qenë afatshkurta deri më datën 24.08.2018 kur ka fillua së zbatuari kontrata e re, kjo kontratë vlen deri më 31.12.2019.
9	Marrëveshjen për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse ndërmjet NEW CO FERRENKELIN COPLEX LLC dhe TRAINKOS Sh.A	"NEW CO FERRENKELIN COPLEX LLC" - TRAINKOS Sh.A.	E nënshkruar më 24.08.2018 si pjesë e aneks kontratës bazë	Është pjesë e aneksit të kontratës bazë dhe precizon vetëm mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse, vlenë poashtu deri më 24.08.2018.
10	Marrëveshja implementuese për ndërlidhjen e përbashkët të rrjeteve Hekurudhore ndërmjet	H.M. "INFRASTRUKTURA"	15.02.2016	Është e nënshkruar mes kompanive relevante hekurudhore të dy shteteve dhe pritet për veprime të

	Hekurudhave të Maqedonisë- Infrastruktura dhe Hekurudhave të Kosovës,	H.M. “TRANSPORTI” - “TRAINKOS” SH.A. “INFRAKOS” SH.A.		mëtutjeshme të koordinuara nga MI-ja.
11	Dispozitat e përbashkëta për rregullimin e Komunikacionit kufitar hekurudhor në linjën kufitare Vollkovë-Hani I Elezit	H.M. “INFRASTRUKTURA” H.M. “TRANSPORTI” - “TRAINKOS” SH.A. “INFRAKOS” SH.A.	15.02.2016	Është e nënshkruar mes kompanive relevante hekurudhore të dy shteteve dhe pritet për veprime të mëtutjeshme të koordinuara nga MI-ja.
12	Marrëveshjen për qasjen në binarë ndërmjet RAILTRANS L.L.C. dhe INFRAKOS SH.A.	“RAILTRANS L.L.C.” - “INFRAKOS SH.A.”	07.10.2016	Numer protokolli 625
13	Marrëveshje për bashkpunim të ndërsjelltë për transportin hekurudhor	“RAILTRANS L.L.C.” - “MZ TRANSPORT AD-SKOPJE”- MACEDONIA	14.02.2017	Numër protokolli 340/1
14	Kontratë për mirëmbajtje, servisim dhe riparim të lokomotivave	“RAILTRANS L.L.C.” - “EXPRESS SERVICE Ltd”- RUSE ,BULGARIA	10.05.2016	

6.11. Plani Strategjik 2019 – 2023

ARH, gjatë këtyre viteve të funksionimit ka bërë progres të rëndësishëm jo vetëm në hartimin e legjislacionit sekondar por edhe në zhvillimin dhe përafrimin e procedurave administrative dhe sistemeve, me praktikat më të mira të BE-së. Duke mos lenë anash edhe kontributin në sigurinë hekurudhore, punën në licencimin e operatorëve aktual dhe të operatorëve të rinj, regjistrimin dhe krijimin e regjistrisë të të dhënave me mjete lëvizëse, monitorimin e tregut hekurudhor, etj.



Me qëllim të definimit të vizionit dhe misionit të ARH-së, në arritjen e objektivave strategjike dhe aktiviteteve specifike për periudhën e ardhshme pesë vjeçare dhe me qëllim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ARH gjatë vitit 2018 ka përgatitur edhe

Planin Strategjik për periudhën 2019 – 2023. Prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë konsistente me vizionin dhe misionin e ARH-së dhe me objektivat strategjike të tij që dalin nga autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore të ARH-se të përcaktuara me Ligjin e Hekurudhave të Kosovës, në përputhje me dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Transportit, siç përmendet në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2018 dhe në harmoni me rregulloret më të fundit evropiane, sidomos Paketën e 4-të Hekurudhore.

Ky dokument është rezultat i punës ekipore të grupit punues të udhëhequr nga Bordi Mbikëqyrës i ARH – së. Ndërsa procesin e hartimit të Planit Strategjik 2019 - 2023 e ka mbështetur Komisioni Evropian përmes Misionit të Ekspertëve të TAIEX-it, të cilët gjatë punëtorisë tre ditore kanë dhënë eksperiencat e tyre profesionale, për të nxjerrë një Plan Strategjik të suksesshëm dhe profesional.



Për të mbështetur zbatimin e kësaj strategjie është hartuar edhe Plani i Veprimit i cili është një pjesë integrale e Planit Strategjik dhe përcakton aktivitete konkrete, njësitë përgjegjëse organizative dhe afatet kohore.

6.12. Administrata

ARH, përkujdeset që të gjitha proceset administrative të jenë në përputhje me rregullativen ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të adresuara në kuadër të ARH-së, siç janë:

- **Mbështetja e përgjithshme për strukturat e ARH-së;**
- **Menaxhimin e burimeve njerëzore dhe çështjeve të personelit;**
- **Inicimin e aktiviteteve të prokurimit dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve dhe mallrave;**
- **Mbikëqyrjen e çështjeve të logjistikës dhe pasurisë së ARH-së;**
- **Administrimin e arkivës dhe librit të protokollit**
- **Mirëmbajtjen e teknologjisë informative.**

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore jemi të obliguar që t'i zbatojmë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me Shërbimin Civil. Stafi i ARH-së janë shërbyes civil sipas ligjit, me përjashtim të anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të cilët janë të emëruar publik. Në këtë fushë jemi të obliguar të bashkëpunojmë me Departamentin e Administrimit të Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike si dhe me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, si organ mbikëqyrës i zbatimit të legjislacionit të Shërbimit Civil. Gjatë vitit 2018, ne si institucion kemi pasur një (1) proces të rekrutimit të jashtëm për 4 pozita të ndryshme si dhe dy (2) procese të rekrutimit të brendshëm për dy pozita të ndryshme.

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive në mbikëqyrjen e logjistikës dhe pasurisë së ARH-së, zbatohen rregulloret e nxjerra nga Ministria e Administratës Publike. Po ashtu gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive në administrimin e arkivës dhe librit të protokollit, ARH zbaton Ligjin për Administrimin e Punëve në Zyrë dhe akte nënligjore që rrjedhin nga ky ligj.

6.13. Financat

Duke njohur nevojën për përmirësimin e shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësiive buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar, ARH vepron dhe operon në bazë të: Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Vlerësuar si informatë përmbledhëse dhe të përgjithshme në aspektin financiar, ARH ka vazhduar me procesimin e të gjitha pagesave ,dalë si obligime zyrtare të ARH-se si dhe me inkasimin e të hyrave si rezultat i ofrimit të shërbimeve të saj në fushën e licencimit, sigurisë, rregullimit të tregut dhe interoperabilitetit. Këto të hyra bazohen në Ligjin e Hekurudhave dhe Rregullorën Nr. 01/2017 për Taksa dhe Gjoha.

6.13.1. Pasqyrat financiare

Në formë tabelare janë paraqitur pasqyrat financiare dhe rrjedhshmëria e transaksioneve financiare të ARH-së sipas kategorive buxhetore.

Tabela 5. Pasqyrat financiare për vitin 2018

Përshkrimi	Buxheti i aprovuar - fillestar	Buxheti i aprovuar - final - pas shkurtimeve buxhetore	Shpenzimet	Shpenzimet %
Paga dhe mëditje	214,473.00	191,531.10	191,531.10	100 %
Mallra dhe shërbime	167,179.00	167,179.00	105,041.38	62,83%
Shpenzime komunale	6,400.00	5,604.00	5,262.62	93,90 %
Gjithsej	388,052.00	364,314.10	301,835.10	82,85 %

Për një sqarim të përgjithshëm do të japim një gjendje të përgjithshme financiare dhe një ndarje krahasuese për të gjitha kategoritë buxhetore, duke paraqitur të dhënat e vitit paraprak, të cilat na japin një pasqyrë më të mirë, më të qartë dhe më me vizion për të ardhmen e ARH-së.

Ndarjet buxhetore në total nga të gjitha Kategoritë Buxhetore, Varianca dhe Krahasimet

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

Shënime	2018		2017		2016		
	Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti final (Ndarja) B	Realizimi C	Varianca D=C-B	Realizimi E	Realizimi F	
	€	€	€	€	€	€	
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Tatimet	14						
Të hyrat vetanake	15						
Donacionet	16						
Pranimet kapitale	17						
Fondi i Privatizimit	18						
Huazimet	19						
Tjera	20						
Pranimet totale të mbledhura për FKK-në		-	-	-	-	-	
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	21	214,473.00	191,531.10	191,531.10	-	180,726.45	124,917.77
Mallrat dhe shërbimet	22	167,179.00	167,179.00	105,041.38	62,137.62	94,915.48	70,337.36
Shërbimet komunale	23	6,400.00	5,604.00	5,262.62	341.38	6,302.28	5,996.37
Transferet dhe subvencionet	24				-		
Shpenzimet kapitale	25	2,000.00	-	-	-	-	-
Fondi i privatizimit	26						
Kthimi i huazimeve							
Tjerat	27						
Totali i pagesave i bërë nga BRK nëpërmes LIVTh		390,052.00	364,314.10	301,835.10	62,479.00	281,944.21	201,251.50

Tabela 6. Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH per vitin 2018

Vëmendje: Ndryshimet buxhetore finale nga këto fillestare janë si rezultat i ndryshimeve buxhetore(shkurtime/kursime) nga niveli qendror sipas vendimeve qeveritare nr.02/70 i datës 19.10.2018 dhe nr.07/80 i datës 18.12.2018.

Përshkrimi	GQ	2018		Totali	2017	2016
		THV	GPD			
	€	€	€	€	€	€
Pagesat						
Neto pagat		161,408.23	-	161,408.23	151,963.53	106,109.07
Pagesat për sindikata -0.10% te 0.50%						
Pagesa neto për punë jashtë orarit						
Pagesa për punë me orar të shkurtuar						
Pagesa për punë në ndërrim të natës						
Pagesa neto për pushim të lehonisë						
Mëditjet e delegatëve dhe komisioneve						
Punëtorët me kontratë						
Tatimi në të ardhura personale		11,881.99	-	11,881.99	11,550.54	6,911.76
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		9,120.44	-	9,120.44	8,606.19	5,948.47
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		9,120.44	-	9,120.44	8,606.19	5,948.47
Shujtat						
Gjithsej Pagesat	-	191,531.10	-	191,531.10	80,726.45	124,917.77

Tabela 7. Realizimi i buxhetit për paga

Paga: Kemi një realizim të buxhetit prej **100 %**

Përshkrimi	2018				2017	2016
	GQ	THV	GPD	Totali	€	€
	€	€	€	€		
Pagesat						
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar	10,110.11			10,011.11	20,535.26	5,701.71
Shpenzimet e akomodimit	8,742.06			8,742.06	1,070.28	2,794.94
Shpenzimet e ushqimit dhe meditive	14,158.95			14,158.95	6999.93	7,751.03
Shërbimet e telekomunikimit	9,185.00			9,185.00	8,485.00	6,360.00
Shpenzimet për shërbime	4,611.03			4,611.03	15,015.00	5,302.70
Sherbime kontraktuese tjera	-			-	2,753.41	
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	-			-	99.00	491.70
Mobiljet dhe pajisjet tjera 1000 - 5000 Euro	7,381.70			7,381.70	3,160.00	
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	3,420.75			3,420.75	5,556.00	3,936.18
Derivatet dhe lëndët djegëse	8,405.47			8,405.47	5,951.00	7,528.94
Shërbimet financiare	334.40			334.40	-	
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	7,710.21			7,710.21	8,040.00	7,261.15
Mungesa në arkë-kthimet					-	
Mirëmbajtja	4,969.00			4,969.00	4,199.80	4,919.97
Qiraja	23,613.00			23,613.00	19,373.00	17,683.33
Shpenzimet e marketingut	949.50			949.50	602.00	462.70
Shpenzimet e përfaqësimit	1,450.20			1,450.20	906.00	143.00
Vendimet e gjykatave	-			-	-	-
Tatimi						
Servisimi i borxhit						
Gjithsej Pagesat	105,041.38	-	-	105,041.38	94,915.48	70,337.36

Tabela 8. Pasqyra e shpenzimeve në kategorin mallra dhe shërbime

Mallra dhe Shërbime: Kemi një realizim të buxhetit prej **62,83 %**

Sqarim: Tek kategoria e Mallrave dhe shërbimeve janë të përfshira edhe obligimet e mbetura në fundvit (dhjetori i vitit paraprak) për shkak të mbylljes së sistemit të pagesave nga MF.

Informatë plotësuese: Si rezultatet i mos finalizimit të procedurave tenderuese nga ana e AQP-së, të disa kërkesave institucionale-me blerje nga mallra dhe shërbimet gjatë vitit 2018 e që tani i kemi si aktivitet bartje për vitin 2019, kemi paraqitje më të ultë në % tek realizimi i kategorisë-mallra dhe shërbime.

Përshkrimi	2018				2017	2016
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Rryma	2,498.04			2,498.04	3,400.00	3,129.72
Uji						
Mbeturinat	56.40			56.40		
Telefon	2,708.18			2,708.18	2,902.28	2,866.65
Gjithsej Pagesat	5,262.62	-	-	5,262.62	6,302.28	5,996.37

Tabela 9. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë Shpenzime Komunale

Shpenzime Komunale: Kemi një realizim të buxhetit prej **93.90 %**

Sqarim: Poashtu tek kategoria e Shpenzimeve komunale janë të përfshira edhe obligimet e mbetura në fundvit (dhjetori i vitit paraprak) për shkak të mbylljes së sistemit të pagesave nga MF.

Të hyrat vetanake

Përshkrimi	Shënime	2018	2017	2016	% e totalit	% e ndryshimit
		€	€	€		
Të hyrat nga taksat 1 të ARH-së		3,250.00	2,450.00		%	%
Të hyrat nga taksat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria e ARH-së					%	%
Pranimet tjera të ARH-së					%	%
Totali		3,250.00	2,450.00	0	0%	%

Tabela 10. Pasqyra e të hyrave vetanake

ARH gjatë vitit 2018 ka vazhduar me inkasimin e mjeteve përmes Taksave, Gjobave, Licencave, Lejeve të Sigurisë dhe pranimet tjera si të Hyra Institucionale.

Përshkrimi	2018				2017	2016
	GQ	THV	GPD	Totali		
	€	€	€	€	€	€
Pagesat						
Subvencionet për entitetet publike						
Subvencionet për entitetet kulturore						
Subvencionet për entitetet jo-publike						
Transfere për qeveri tjera						
Pagesat për përfituesit individualë						
Pensionet bazë						
Pensionet invalidore						
Pensionet ose ndihmat sociale						
Pensionet e TMK-së						
Pensionet e kategorisë I (anëtarët e familjes)						
Pensionet e kategorisë II (anëtarët e familjes)						
Pagesat për invalidët e luftës						
Pagesat për invalidët civilë						
Pagesat për familjet e viktimave të luftës						
Pensionet e përkohshme të Trepçës						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

Tabela 11. Pasqyra e të hyrave në kategorinë subvencione dhe transfere

Gjatë këtij viti nga kjo kategori nuk kemi pasur ndonjë përkrahje apo subvencion as nga Qeveria as nga Donatorët apo ndonjë nivel tjetër.

Përshkrimi	2018				2017	2016
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Ndërtesat					-	-
Ndërtimi i rrugëve					-	-
Kanalizimi					-	-
Ujësjetllësi					-	-
Energjia, gjenerimi, bartja dhe furnizimi					-	-
Pajisje mbi 1000 Euro					-	-
Automjete transporti						
Makineria-Blerja e veturës zyrtare	-			-	-	-
Kapitalet tjera					-	-
Toka						
Pasuritë e paprekshme						
Transferet kapitale për entitetet publike						
Transferet kapitale për entitetet jopublike						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

Tabela 12. Pasqyra e shpenzimeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale

Kategoritë ekonomike	Planifikimi / Ndarja fillestare dhe finale	Realizimi
	Fillestare	
6-11000 · PAGAT & MEDITJET	214,473.00	
6-11110 · Paga Bruto Përmes Payr		161,408.23
6-11115 · Pagesa për sindikata		0
6-11500 · Tat.i ndaluar ne te ardhura personale		11,881.99
6-11600 · Kontributi pensional nga punëtori		9,120.40
6-11170 · Kontributi për pension nga punëdhënësi		9,120.44
Total 6-11000 · PAGAT & MEDITJET		191,531.10
	Fill / 214,473.00 Fin / 191,531.10	
6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET	Fillestare	
6-13100 · Shpenzimet e Udhëtimit	31,500.00	
6-13143 · Shpenz. eudhet. jashte vendit		10,110.11
6-13133 · Shpenz. tjeraudhet. zyrtar mbre		0
6-13142 · Akomodim gjate udhetimit zyrtar		8,742.06
6-13141 · Ushqim/Meditjet e udhetimit zyrtar		14,158.95
6-13140 · Sh. Udhëtimit Jashtë Vendit		0
Total 6-13100 · Shpenzimet e Udhëtimit		
71706 kthim i mjeteve(avansi)		0
71041 kthim i mjeteve(avans regj Pr NLB)		0
6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit		0
	8,000.00	
6-13310 · Interneti		0
6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo		9,185.00
6-1320A · Mbushje		0
6-1320B · Roaming		
Total 6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo		
6-13330 · Komunikimet Tjera		
6-13330 - Dergesat postare		
Total 6-13330 · Komunikimet Tjera		

	62,500.00	
6-13480 - Shpenzimet perantarsim		0
6-13460 · Sherb. tjera kontr.		893.33
6-13450 · Sherbime shtypje-jomarketing		1,143.20
6-13410 · Sh. Arsimit & Trajnimit		2,574.50
6-13430 · Sh. Ndryshme Shendetesor		
6-13440 · Sh. Ndryshme intel, keshilldh		0
6-13470 · Sherbimet Teknike		0
Total 6-13400 · Sherbimet Kontraktuese		
6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000		
6-13501 · Mobilie		2,580.00
6-13503 · Kompjuter		3,334.50
		1,229.56
6-13508 · Pajisje trafiku		
6-13509 · pajisje Tjera		237.64
Total 6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000		0
6-13600 · Blerje Tjera		
	8,000.00	
6-13660 · Akomodim		
6-13610 · Furnizime për Zyre		106.25
6-13620 · Furnizim me ushqim & pi		3,314.50
6-13640 · Furnizime Pastrimi		
6-13650 · Furnizime me veshmbathje		0
Total 6-13600 · Blerje Tjera		
6-13700 · Derivate & Lënde djegëse		
	14,379.00	
6-13780 · Karburant për Vetura		3,382.68
6-13770 · Karburant për gjenerator		
6-13720 · Naftë për ngrohje		5,022.79
Total 6-13700 · Derivate & Lënde djegëse		
6-13800 · Llogarit e Avansit		
6-13820 · A. perudhetime zyrtare		334.4

Total 6 - 13800 · Llogarit e Avansit		
6-13900 · Sherbimet Financiare	10,000.00	
6-13950 · Rexhistrimi i automjeteve		90
6-13952 · Taksa komunale e regjistrimit		232.5
6-13951 · Sigurimi i Automjeteve		642.51
6-13953 · Sigurimi I Ndertesave dhe tjera		6,745.20
Total 6 - 13900 · Sherbimet Financiare		
6-14000 · Mirembajtja	6,800.00	
6-14031 · Mirembajtja e rrugeve regjional		
6-14010 · Mir.&Riparimi Autmjetev		1,339.00
6-14020 · Mir. e Ndertesave		3,000.00
6-14060 · Mir. paisj		230
6-14040 · Mir. TeknologjisInform		98
6-14050 · Mir. Mobilive&Paisjev		302
Total 6-14000 · Mirembajtja		
6-14100 · Qiraja	24,000.00	
6-14110 · Ndertesat		23,613.00
Total 6 - 14100 · Qiraja		
6-14200 · Shpenzimet e Marketingu	500,00	
6-14230 · Shpenz.per informim publik		719.5
6-14210 · Reklama dhe Konkurse		230
6-14220 · Botime dhe Publikime		
Total 6-14200 · Shpenzimet e Marketingu		
6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim	1,500.00	
6-14310 · Drekat Zyrtare		1,450.20
Total 6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim		
6-14400 · Shpenzimet per vendim dhe gjyka		
6-14410 · Shpenzimet per vendim te gjykat		0
Total 6-14400		
Total 6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET		
	Fill / 167,179.00 Fin / 167,179.00	105,041.38

	Fillestare	
6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE	6,400.00	
6-13210 · Rryma		2,498.04
6-13220 · Uji		
6-13230 · Mbeturinat		56.4
6-13240 · Ngrohja Qendrore		
6-13250 · Telefoni PTK		2,708.18
Total 6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE		5,262.62
	Fill/6,400.00 Fin/5,604.00	
6-20000 · Subvencionet&Transferet		
6-21110 · Su. per Entitetet Publi		
6-22200 · Pag. PerfituesIndividu		
Total 6-20000 · Subvencionet&Transferet		
6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE		
6-31210 · Ndertimi i Autostrate		
6-31230 · Ndertimi i rrugeve lokale		
6-31220 · Ndertimi i rrugeve regjionale		
6-31700 · Vetura zyrtare		0
6-31910 · Avancë për Investime		
Total 6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE		0
	0	
	Fill / 388,052.00 Fin / 364,314.10	

Tabela 13. Detajet e shpenzimeve nga kategoritë e Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve, Shpenzimeve Komunale dhe Shpenzimeve Kapitale për vitin 20178 (Janar- Dhjetor 2018)


6.14. Prokurimi

ARH, sipas obligimeve ligjore ka bërë përgatitjen e Planifikimit të Prokurimit, në të cilin janë paraparë të gjitha kërkesat për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve në bazë të kërkesave të pranuar nga të gjitha njësitë e kërkesës.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive tona, sipas Planifikimit Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2018, dokument standard i aprovuar nga KRPP dhe sipas Planit të Punës për vitin 2018, mbi bazën e të cilit janë kryer të gjitha aktivitetet e parapara të prokurimit, janë paraparë të realizohen gjithsejtë 6 aktivitete të prokurimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për funksionimin e ARH-së. Sipas Nenit 21A të Ligjit 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, kemi bërë përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave me dokumentacionin përcjellës për të kërkuar nga AQP zhvillimin e të gjitha aktiviteteve sipas planifikimit dhe nevojave të ARH-së.

ARH në mënyrë të vazhdueshme ka një bashkëpunim të ngushtë dhe efikas me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe me Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Grafiku 1. Realizimi i aktiviteteve gjatë vitit 2018



6.15. Marrëdhëniet me Publikun dhe Qasja në Dokumente Publike

Me qëllim të planifikimit dhe koordinimit të Komunikimit me Publikun përmes bashkërendimit të planeve të komunikimit me planin vjetor të punës së Departamenteve të ARH-së, zbatimit të plotë të Ligjit 03/L-215, për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregullores Nr. 03/2011 – për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, ARH është e hapur me transparencë të plotë dhe gatishmëri për bashkëpunim me çdo mekanizëm, institucion apo organizatë që për qëllim ka ngritjen e nivelit të përgjegjësisë në Institucionet Publike.

Me qëllim të implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ne si ARH i jemi përgjigjur në formën më të mirë të mundshme dhe në harmoni të plotë me ligjin, çdo kërkesë që kemi pranuar për qasje në dokumente publike. Marrë për bazë natyrën e veprimtarisë profesionale të ARH-së si dhe kufizimet buxhetore, ne si institucion nuk kemi pas mundësi të bëjmë organizimin e ndonjë aktiviteti i cili ndërlihet direkt me zbatueshmërinë dhe implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, por për të qen sa më transparent dhe për ta bërë më të lehtë komunikimin me publikun ARH ka të caktuar Zyrtarin Përgjegjës për Komunikim me Publikun dhe Qasje në Dokumente Publike, ka ueb faqen zyrtare funksionale në të cilën paraqiten të gjitha aktivitetet e ARH-së, raportet vjetore si dhe janë të publikuara informata me interes publik të cilat e orientojnë publikun për të drejtat e tij dhe mënyrën për qasje në dokumente publike/zyrtare. Natyrisht se sikur në çdo fushë tjetër edhe në këtë fushë ka sfida të ndryshme të cilat paraqiten gjatë implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, por me një koordinim më të mirë ndërinstytucional dhe me një angazhim më të madh të institucioneve relevante konsiderojmë se do të tejkaloheshin edhe sfidat të cilat paraqiten gjatë implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Të dhënat e detajuara lidhur me kërkesat për Qasje në Dokumente Publike drejtuar ARH-së gjatë vitit 2018, janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Numri i kërkesave të pranuar			
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme
1	0	1	0

Tabela 14. Numri i kërkesave të pranuar

Qasja e lejuar	Numri
Në afat, sipas ligjit	0
Me pagesë	0
Pa pagesë	0

Tabela 15. Qasja e lejuar

Qasja e refuzuar	Numri
E plotë	1
E pjesshme	0
Pa përgjigje	0

Tabela 16. Qasja e refuzuar

Kërkesat për rishqyrtim	Numri
Numri total i rishqyrtimeve	0
E lejuar	0
E refuzuar	0
E pjesshme	0

Tabela 17. Kërkesat për ri-shqyrtim

Numri i aktvendimeve të lëshuara për refuzim: 0 (zero)

Refuzimet dhe qasjet e kufizuara	Numri
1. Përbërjet nga neni 12: (specifikoni cila pikë, nga lista e mëposhtme)	
1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;	
1.2. sigurisë publike;	
1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;	x
1.4. hulumtimeve disiplinore;	
1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;	
1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;	x
1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;	x
1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;	
1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;	
1.10. mjedisit, apo,	
1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.	
2. Neni 10. (Pa përgjigje)	
3. Dokumentet e klasifikuara	
4. Të dhënat personale, sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	
5. Arsye tjera të refuzimeve, (ju lutem specifikoni)	

Tabela 18. Refuzimet dhe qasjet e kufizuara

Kërkesat e paraqitura	Numri
Në mënyrë elektronike	1
Kopje fizike	0
Elektronike dhe kopje fizike	0

Tabela 19. Kërkesat e paraqitura

Mënyra e dërgimit të përgjigjeve	Numri
Në mënyrë elektronike	1
Kopje në letër	0
Elektronike dhe kopje	0
CD	0

Tabela 20. Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

Profili	Numri
Gazetarë	
Shoqëri civile	
Organizata buxhetore	
Individë	
Studentë	
Parti politike	
Tjera (specifiko)	Biznes – Operator Ekonomik

Tabela 21. Profili i aplikuesve dhe dokumentet e kërkuara

Dokumenti	Numri
Buxhet, shpenzime	
Vendime	
Projektligje	
Statistika	
Kontrata	x

Projekte	
Konkurse	
Tjera, specifikoni	Certifikata e regjistrimit të Biznesit dhe Referenca

Tabela 22. Lista e dokumenteve të kërkuara

Duke i krahasuar të dhënat e paraqitura në tabelat e mësipërme me të dhënat e dy viteve të kaluara, vërehet një trend në rënje i interesimit për kërkesa për qasje në dokumente publike, gjatë vitit 2018.

Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të efikasitetit mbi zbatueshmërinë e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, rekomandojmë që të organizohen aktivitete të ndryshme me karakter informues dhe këshillues, ku si rezultat do të kishim ngritje të kapaciteteve profesionale dhe njohurive më të gjëra rreth kësaj fushe për zyrtarët përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike. Gjithashtu, një element mjaft i rëndësishëm i ngritjes së performancës së zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike do të ishte edhe organizimi i fushatave sensibilizuese të opinionit të gjerë mbi të drejtën që ky ligj ua garanton për Qasje në Dokumente Publike.

2016				2017				2018			
Numri i kërkesave të pranuar				Numri i kërkesave të pranuar				Numri i kërkesave të pranuar			
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme	Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme	Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme
3	2	0	1	6	3	1	2	1	0	1	0

Tabela 23. Paraqitja tabelare e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike, në tri vitet e fundit

7. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është në proces të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018. Ky auditim është fokusuar në pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm .

Ndërsa në maj të vitit 2018 kanë nxjerr dhe njëkohësisht kanë publikuar Raportin e Auditimit (nr. dokumenti 23.19.1-2017-08) për pasqyrat financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të vlerësuar me “Opinion i pamodifikuar”.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtijë Raporti.

Zyra Kombëtare e Auditimit si konkluzione dhe rekomandime kryesore ka paraqitë se duhet në vazhdimësi të sigurohet prezentim i drejtë dhe i plotë i informatave në pasqyrat financiare, të vazhdohet me vlerësim më të detajuar të fushave për të identifikuar aryet për paraqitjen e dobësive si dhe të sigurohet që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar si dhe janë bërë ndryshimet adekuate në përmirësim të aranzhimeve në zbatim të rekomandimeve, në fushën e planifikimit strategjik si dhe regjistrin të rreziqeve.

8. Shtojcat

8.1. Shtojca I - Përshkrimi i Hekurudhave të Kosovës

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Republikës së Kosovës me një gjatësi prej 333,45 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,40 km. Linja e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Linjat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës, përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Këto linja kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me shtetet fqinje si me Maqedoninë e Serbinë dhe përmes tyre edhe me shtetet e tjera.

Hekurudhat e Kosovës kryesisht ndahen në dy linja:

Linja Veri – Jug:

Shtrihet nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s (linjë funksionale).

Linja Verilindje - Perëndim:

Përbëhet nga tri degë:

- **Linja Lindore** - nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me gjithsejtë 45 km gjatësi,
 - Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (linjë funksionale),
 - Bardhosh-Podujevë 30 km (linjë jo – funksionale),
- **Linja Perëndimore** nga Fushë Kosova deri në Pejë me gjithsejtë 81 km gjatësi (linjë funksionale),
- **Linja Jug - Perëndim** nga Klina deri në Prizren me gjithsej 58 km gjatësi,
 - Klinë – Xërxe 35 (linjë funksionale),
 - Xërxe – Prizren 32.5 (linjë jo – funksionale).



Fotografia10. Harta e Hekurudhave në Republikën e Kosovës